# GAZETA SHQIPTARE







Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7474 E martë 20 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)







Opinioni i Ditës

Nga FLORIAN DOSCHEK

## "Titaniku" i Austrisë në brigjet shqiptare



Për "Titanikun" foli e gjithë bota..." thoshte dikur një i mbijetuar nga fatkeqësia e natës së 18-19 marsit 1918, ndërsa anija austriake "Linz" u harrua. Kjo tragjedi ...

Vijon në faqen 20



Opinioni i Ditës

Nga AZGAN HAKLAJ

## Marsi, pranvera e lirisë

Në kalendarin europian marsi është muaji i tretë i vitit, perëndi e luftës për romakët e lashtë, Dita e Sulltan Novruzit apo ditëlindja e Imam Aliut ...

Vijon në faqen 21



Ministri i Jashtëm do t'u japë plotfuqinë negociatorëve

# "Deti", Meta i jep autorizimin Bushatit: Garanto sovranitetin, respekt Kushtetueses

Presidenti: Të respektojë aktet ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë

Nga DARINA TANUSHI

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, i ka dhënë dje autorizimin ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, për të vijuar negociatat me palën greke për kufirin detar. Por, në autorizimin e tij, kreu i shtetit ...

Në faqen 3

QEVERIA MERR NE "MBROJTJE" 10 KATEGORI NE NEVOJE, RASTET QE PERJASHTOHEN

# TAKSA E SHTEPISE, KUSH PERJASHTOHET NGA DETYRIMI

Gratë dhe pensionistët që janë kryefamiljarë do të përfitojnë nga lehtësirat. Më 1 prill taksa e re, jashtë skemës edhe hotelet me 5 yje



*(Në foto)* Pallate në Tiranë

Në faqen 7

APELI

## Rama: S'ka ndihmë ekonomike për ata që e refuzojnë punën e ofruar

Në faqen 2

NGJARJA NE 2016

## Ekzekutimi i Çollakut, burg përjetë për Denis Shtrazën, avokati kërkoi pafajësi

Në faqen 9

LISTA ME 4900 PERFITUES

## ATP: Dosjet e vitit 1996, pronarët që kompensohen dhe aplikimet e ezauruara

Në faqet 17-19

NJOHJE ME AUSTRINE

## Pensionet e emigrantëve, Astrit Hado: Jemi në vendnumëro, mungesë e vullnetit politik

Në faqen 11

RENDITJA E APLIKANTËVE



## Lista, shpallen emrat e infermierëve fitues, kaluan fazën e parë dhe fazat e mëtejshme

Në faqet 12-13

Lihen të lirë edhe 9 zyrtarë të tjerë. Në burg, juristi i bashkisë dhe hartografi i hipotekës

# Skandali i pronave, lirohet kryebashkiaku i Lezhës

*Gjykata vendos "Arrest shtëpie" dhe mbikëqyrje elektronike për Frrokajn*

LEZHË- Pak ditë pas superoperacionit "Ranishtja 4", ku u arrestuan dhe u ndaluan 12 persona dhe 11 të tjerë u shpallën në kërkim në lidhje me skandalin e pronave në zonën "Rana e Hedhun" në Shëngjin, Gjykata e Shkallës së Parë e Lezhës ka liruar kryebashkiakun Fran Frrokaj dhe 9 zyrtarë të tjerë të bashkisë dhe hipotekës. Ndërsa ka lënë në burg 2 zyrtarë të tjerë. Gjatë seancës gjyqësore maratonë, togat e zeza të Lezhës kanë bërë rivlerësimin e masës së sigurisë ...



Në faqen 6

# SITUATA POLITIKE

## REAGIMET

Kryeministri iu përgjigjet akuzave të opozitës: Ligji është i qartë

# Rama: S'ka ndihmë ekonomike për ata që e refuzojnë punën e ofruar

## "Trajnohuni dhe merrni 55 mijë lekë pagesë"



Nga takimi Rama - Tsipras

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje se kush është i aftë për punë dhe e refuzon atë, nuk do të marrë ndihmë ekonomike. I pranishëm në një prej fabrikave të këpucëve në Kamëz, Rama iu përgjigj edhe akuzave të opozitës për ndihmën ekonomike. Punësim në vend të ndihmës ekonomike është objektivi i qartë i qeverisë për të ndihmuar të gjitha familjet në nevojë, përmes bashkëpunimit të biznesit me Shërbimin Kombëtar të Punësimit. Një shembull i mirë për këtë është fabrika e këpucëve "Euroasia Footwear" në Kamëz, e cila në një vit të aktivitetit të saj në Shqipëri ka punësuar nëpërmjet bashkëpunimit me zyrën e punës rreth 1 mijë punëtorë, një pjesë e mirë e të cilëve persona që trajtoheshin me ndihmë ekonomike. Kryeministri Edi Rama ishte sot në këtë fabrikë, ku e pranishme edhe ambasadorja e Kinës në Shqipëri, Jiang Yu. "Deri tani jemi pothuajse 1000 punëtorë. Kemi një bashkëpunim shumë të ngushtë me zyrën e punës. Deri në fund të qershorit do na duhet të shtojmë edhe 250 punëtorë më shumë, duke qenë se ne kemi edhe një fabrikë tjetër në Valias", shprehet një tjetër përfaqësuese e kompanisë. Kryeministri Rama u shpreh se ndihma ekonomike nuk duhet parë më si një status i përhershëm, por duhet shfrytëzuar çdo mundësi për të dalë nga varfëria përmes punës. "Ligji është shumë i qartë, në qoftë se ti ke një ofertë për punë dhe e refuzon, herën e dytë del nga skema e ndihmës ekonomike. Kjo është e qartë, sepse është e pamundur që të vazhdojë të jepet ndihmë ekonomike për dikë që është fizikisht i aftë për punë dhe që e refuzon punën, ndërkohë që ndihma ekonomike është për më të varfrit dhe për sa kohë janë në pamundësi për t'u integruar, nuk është një status i përjetshëm varfërie e mjerimi, që e paralizon komplet familjen dhe u heq çdo perspektivë prindërve dhe kryetarëve të familjes", u shpreh kryeministri Rama. Për t'i përgatitur punëkërkuesit për tregun e punës, kryeministri Rama i ftoi të përfitojnë nga një tjetër nismë të qeverisë, trajnimit kundrejt pagesës së të gjithë personave që pranojnë të punësohen me ndërmjetësimin e zyrave të punës. "Ne kemi edhe skemën tani, që japim pagesë për trajnimet. Kush do që është i gatshëm që të trajnohet, atëherë ne japim 55 mijë lekë të vjetra në muaj mbështetje për trajnimin dhe nuk bëhet nëpërmjet kompanisë. Është një masë e re që e kemi vënë, që është faktikisht sa mesatarja e ndihmës ekonomike", u shpreh kryeministri. "Kjo histori, - shtoi kryeministri Rama, - nuk mund të vazhdojë pafund. Duhet ndarë kush është i aftë fizikisht për punë dhe kujt i ofrohet puna, duhet ta pranojë. Përndryshe, si do ta paguajnë të tjerët, me kontribute nga taksat, që të rrijë në shtëpi, i mpirë atje edhe që pak nga pak të bëhet psikologjikisht i paaftë për të marrë përsipër punën".



Kryeministri Edi Rama, dje në fabrikën e këpucëve në Kamëz

**DEKLARATA**

"Ligji është shumë i qartë, në qoftë se ti ke një ofertë për punë dhe e refuzon, herën e dytë del nga skema e ndihmës ekonomike. Kjo është e qartë, sepse është e pamundur që të vazhdojë të jepet ndihmë ekonomike për dikë që është fizikisht i aftë për punë dhe që e refuzon punën, ndërkohë që ndihma ekonomike është për më të varfrit", tha Rama.

**INTEGRIMI**

Kryeministri Edi Rama dhe ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati ndodhen në Bruksel sot, ku marrin pjesë në një konferencë me pjesëmarrjen e presidentit të Parlamentit Europian, Antonio Tajani, përfaqësueses së lartë të BE, Federica Mogherini, organizuar nga eurodeputeti David Sassoli.

## Ministri i Jashtëm: Diplomacia ekonomike, me rëndësi

# Bushati, me krerët e dhomave të tregtisë: Të promovojmë interesat ekonomike të vendit

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme zhvilloi takimin "Konsultime me Sipërmarrjen mbi Diplomacinë Ekonomike" me drejtues të nivelit më të lartë të dhomave lokale të tregtisë të Shqipërisë dhe drejtues të kompanive më të mëdha, anëtare të këtyre dhomave, në funksion të koordinimit të punës me të gjithë aktorët shtetërorë dhe privatë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, në kuadër të rikonceptimit të rolit të diplomacisë ekonomike dhe si shërbimi diplomatik mund të asistojë dhe kontribuojë maksimalisht në promovimin e produkteve, gjetjen e tregjeve dhe ndërlidhjen e prodhuesve dhe bizneseve shqiptare me partnerë tregtarë dhe biznese homologe të huaja. Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, në fjalën e tij nënvizoi rëndësinë e ndërveprimit mes biznesit dhe shtetit për të promovuar interesat ekonomike të vendit. Bushati u shpreh se, "ne duhet të tejkalojmë dobësitë strukturore në mënyrë që të mund të promovojmë produktet shqiptare dhe të zgjerojmë tregjet dhe partneritet e Shqipërisë. Qasja jonë e re ndaj diplomacisë ekonomike synon të jetë gjithëpërfshirëse dhe të bazohet mbi një strukturë të qartë organizative, të ketë një fokus të veçantë te baza e informacionit, komunikimit në kohë sa më të shkurtër, si dhe të drejtohet nga objektiva të qartë e të matshëm. Zhvillimi ekonomik dhe rritja e mirëqenies janë prioritete absolute të qeverisë dhe në funksion të tyre MEPJ është angazhuar plotësisht në përmirësimin dhe përshtatjen e shërbimeve tona për sfidat e ekonomisë shqiptare".





## Ministri viziton shkollën plotësuese në Londër

# Majko: Diaspora nuk është çështje politike, por kërkon konsensus

Ministri i Shtetit për Diasporën u bë zyrtari i parë i lartë shqiptar që vizitoi shkollën plotësuese shqipe në Kilburn të Londrës. Shkolla e themeluar me iniciativë të organizatave shqiptare që veprojnë atje ofron kurse të gjuhës shqipe gjatë së shtunës. Gjatë bisedës në shkollë, Majko e vuri theksin tek rëndësia e të folurit shqip në familje. Sipas tij, nëna ka rolin kryesor në transmetimin e gjuhës tek fëmijët dhe shmangien e asimilimit të brezave të rinj. Ministri informoi mësuesit, prindërit dhe përfaqësuesit e shoqatës "Ardhmëria" mbi planin e përbashkët të veprimit me qeverinë e Kosovës, sa i përket arsimit shqip në diasporë. Ndërkaq, në takimin me përfaqësues të komunitetit shqiptar në Londër, përfshirë edhe studentë, Majko tha se diaspora nuk është një çështje politike, por ajo kërkon konsensus politik që të mundësohet ecja në një hap e diasporës me shtetin e vet. "Duam të krijojmë një marrëdhënie të qëndrueshme dhe afatgjatë me diasporën, e cila nuk do të zbehet me ndërrimin e qeverive. Po përpiqemi ta institucionalizojmë atë, në mënyrë që të mos mbetet thjesht një dialog në distancë. Shteti shqiptar duhet të jetë në një linjë me diasporën e vet", u shpreh ministri. Majko vlerësoi arritjet dhe sukseset e shqiptarëve në Britaninë e Madhe, por e vuri theksin tek nevoja e një organizimi më të madh në nivele të ndryshme. Duke përmendur aftësitë e brezit të ri, ministri kërkoi më shumë angazhim për ruajtjen e gjuhës dhe identitetit shqiptar.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Ministri i Jashtëm do t'u japë plotfuqinë negociatorëve, pjesë edhe Meçollari

# "Deti", Meta i jep autorizimin Bushatit: Garanto sovranitetin

## "Të respektohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese"

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, i ka dhënë dje autorizimin ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, për të vijuar negociatat me palën greke për kufirin detar. Por, në autorizimin e tij, kreu i shtetit u kërkon institucioneve të përfshira në këto negociata për marrëveshjen e re që të respektojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë për detin dhe të respektojë aktet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë. "Presidenti i Republikës, Sh.T.Z Ilir Meta në mbështetje të nenit 92 germa 'ë', nenit 116, nenit 121 pika 1, nenit 132 të Kushtetutës; Vendimit nr.15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë; Nenit 6 pika 3, shkronja 'a' të ligjit nr. 43/2016 'Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë', në vijim të kërkesës të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme autorizoi sot, (dje) ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme, z.Ditmir Bushati, të lëshojë plotfuqinë për grupin negociator të Republikës së Shqipërisë për negocimin e 'Projektmarrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë për kufizimin e zonave të tyre detare", thuhet në njoftimin zyrtar të kreut të shtetit, Ilir Meta. Më tej, njoftimi vijon: "Presidenti i Republikës, Sh.T.Z Ilir Meta u kërkon Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, institucioneve shtetërore shqiptare të përfshira në këto negociata dhe grupit negociator, të përmbushin përgjegjësitë e tyre në respekt të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Vendimit nr.15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese, akteve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, kuadrit të brendshëm ligjor, në interes të ruajtjes dhe ushtrimit të sovranitetit territorial dhe juridiksionit kombëtar dhe të garantimit të sigurisë, dobisë ekonomike e sociale të vendit". Autorizimi i presidentit për plotfuqishmërinë e veprimit të grupit negociator shqiptar me palën greke vjen pas dy takimeve të fundit dy javë më parë me ministrin Bushati, por edhe me kryeministrin Edi Rama. Qysh prej mesit të shkurtit, ministri Bushati i kërkoi Presidentit të Republikës t'i japë autorizimin për të nisur negociatat me Greqinë për të arritur një marrëveshje të re sa i përket kufirit detar. Por, Presidenti i Republikës iu përgjigj edhe publikisht, por edhe me një shkresë ministrit, duke i kërkuar mjaft informacione dhe të dhëna rreth marrëveshjes që do negociohet, takimeve të kryera, negociatorëve apo edhe detaje të tjera që kanë të bëjnë me atë çfarë është diskutuar në dy takimet e Bushatit me Kotzias. Nga ana e saj, Ministria e Jashtme i ktheu përgjigje presidentit dy herë, për shkak të kërkesës së dytë që kreu i shtetit i drejtoi për shtesë informacionesh. Nga ana tjetër, opozita kundërshtoi emrin e një prej negociatorëve të grupit, Artur Meçollarit, duke e etiketuar deri edhe "spiun", akuza që u hodhën poshtë nga Ministria e Mbrojtjes të Shqipërisë. Tashmë mbetet për të parë se cilat do të jenë hapat e mëtejshëm të grupit negociator.



**TAKIMI**

Presidenti Meta takoi dje ish-kryebashkiakun e Nju Jorkut, Rudi Xhulianin për të cilin tha se "ka lënë më shumë gjurmë në qytetin e Nju Jorkut". Meta tha se, Xhuliani i shprehu ndjenjat më pozitive për shqiptarët e Nju Jorkut dhe të gjithë Amerikës.

Festa kombëtare e Greqisë mbledh bashkë Ruçin, Metën e Lu

## Ambasadorja Surani: Çdo sukses i Shqipërisë, i mirëpritur nga Greqia

Me rastin e ceremonisë së festës kombëtare të Greqisë, ambasada greke në Tiranë ka zhvilluar një pritje me personalitete të ndryshme shqiptare. Ambasadorja greke në Tiranë, Eleni Surani është shprehur se Greqia i mirëpret progreset e Shqipërisë dhe është e hapur për zgjidhjen e problemeve dypalëshe mes vendeve. "Çdo sukses i Shqipërisë është i mirëpritur nga Greqia. Duhet të zgjidhim problemet e të heqim stereotipat. Jemi të angazhuar në zgjidhjen e problemeve dhe vullneti politik në të dyja vendet tona do çojë drejt suksesit", - u shpreh ambasadorja. Në ceremoninë e festës së Greqisë kanë qenë të pranishëm edhe kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi e Presidenti Ilir Meta, por edhe ambasadori amerikan, Donald Lu. Pas dhënies së autorizimit nga Presidenti Meta, kreu i PBDNJ-së Vangjel Dule u shpreh në një prononcim për "News 24" se ky zhvillim ishte i pritshëm dhe i dëshiruar. "Kjo është një fazë e re në marrëdhëniet mes dy vendeve. Çelet rruga në aspektin teknik dhe politik. Por dhe për integrimin e Shqipërisë në BE. Themeli i marrëdhënieve mes dy vende, ato të popujve. Lidershipi politik nuk mund të cenojë marrëdhëniet mes popujve. Ne 4 vitet e fundit kemi bërë hapa mbrapa në këto marrëdhënie. Ndaj është momenti për të rikuperuar kohën e humbur", tha Dule.



Dje në festën kombëtare të Greqisë



Këshilltari i Presidentit të SHBA takon Ruçin e Bashën

## Ish-kryebashkiaku i Nju Jorkut: Shqipëria, partner i qëndrueshëm

Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, priti dje në një takim të veçantë ish-kryetarin e Bashkisë së Nju Jorkut (SHBA), Rudi Xulianin, aktualisht këshilltar personal i Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Donald Trump, si dhe drejtues i Komitetit mbi Sigurinë Kibernetike në Shtëpinë e Bardhë. "Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë partneri strategjik i shqiptarëve dhe ne ju jemi mirënjohës për rolin vendimtar tuajin si në zhvillimin e proceseve demokratike në vend, për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO dhe sigurisht për rolin tuaj në krijimin e shtetit të ri të Kosovës", - u shpreh Ruçi në këtë takim. Kryetari i Kuvendit vuri në dukje faktin se Shqipëria është në rrugën e mbarë të reformave thelbësore për vendin për forcimin e shtetit të së drejtës, për një ekonomi të qëndrueshme dhe mirëqenie të qytetarëve të saj, duke u shprehur besimplotë në vijim e mbështetjes së SHBA-ve për Shqipërinë në këtë drejtim. Nga ana e tij, z.Xhuliani vlerësoi në mënyrë të veçantë kontributin e Shqipërisë në kuadër të NATO-s për sigurinë dhe stabilitetin në botë. Ai u shpreh se SHBA shikojnë tek vendi ynë një partner të qëndrueshëm dhe një kontribuues real në koalicionin kundër terrorizmit për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë në rajon e më gjerë. Z.Xhuliani tha se do t'i propozojë presidentit Trump të vizitojë Shqipërinë për të parë nga hapat e mëdhenj që ka bërë vendi. Ai u takua edhe me kreun e PD-së, Lulzim Basha.



**NJOFTIM ANKANDI**

**Permbarues gjyqesor privat Artan Sima** zhvillon ankandet sipas datave te meposhtme:

**Date 16/04/2018, diten e Hene, ora 16:00,** perfundon ankandi i ri (i dyte), per shitjen e pasurive te paluajtshme te llojit "Are" me sip. 7400 m2, e ndodhur ne fshatin Bitince Devoll, ne vleren 414,400 leke. Pasurite jane lene garanci bankare nga debitori Trashegimtareve te te ndjerit/Debitor znj.Bukurije Sulejman Fezo, znj.Mimoza Fatmir (Foto) Fezo, z.Xhimi Foto Fezo, znj. Arkonnda Foti Fezo, znj. Eliverta Foti Fezo, znj. Luiza Foti (Kasabelli) Fezo banues ne fshatin Bitince, bashkia Devoll, per detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli ne ish Blloku Tirane.
**Ankandet zhvillohet prane zyres se permbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga Avni Rustemi, nr.31 .k,1. Korce. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com**

## KONSTITUIMI
### MBLEDHJA

Komisioni kuvendor për "Tahirin" nis me përplasje, replikat mes anëtarëve

# Plani i hetimit, Paloka: Të nisë verifikimi. Fino: Mos na paragjyko

## *Ndreu: S'jemi në zbor këtu, ti filozofon*

Valentina Madani

Komisioni hetimor për çështjen "Tahiri" dhe fenomenin e kultivimit të lëndëve narkotike zhvilloi dje mbledhjen e parë të konstituimit. Palët u munduan të ruajnë qetësinë, por si për të paralajmëruar vështirësinë e diskutimeve në të ardhmen, edhe caktimi i datës së mbledhjes pasardhëse shkaktoi debat. Socialistët kërkuan një javë kohë për përgatitjen e rregullores, ndërsa demokratët vetëm një ditë. "Nuk e shoh të arsyeshme një javë për të diskutuar, nuk dua as të paragjykoj asgjë, se është dita e parë e komisionit", tha kreu i komisionit, Edi Paloka. Ai përmendi se ngritja e tij është bërë me kërkesë të opozitës dhe synon diskutime mbi veprimtarinë e organeve përgjegjëse për luftën ndaj kultivimit të narkotikëve dhe rastin e trafikut në të cilin dyshohet se është i përfshirë ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri. Ai bëri të qartë se gjatë punës së këtij komisioni do të verifikohen veprimet dhe mosveprimet e organeve hetimore për fenomenin e kultivimit e narkotikëve dhe për ish-ministrin Tahiri. Fill pas fjalës së Palokës reagoi deputetja Ermonela Felaj, sipas së cilës, duhet se paraqitet se çfarë është në plan të hetohet dhe sipas saj, hetimi nuk mund të hapet që sot. "Në mbledhjen e parë të komisionit, ligji e përcakton qartë se çfarë bëhet, kryetari deklaron qëllimin e ngritjes, detyrat e komisionit dhe planin paraprak të hetimit. Hetimi nuk mund të hapet që sot, se duam të dëgjojmë planin paraprak të hetimit dhe pastaj rezervojmë të drejtën të shprehemi", - tha ajo. Deputeti Sterkaj propozoi emrin e Klotilda Ferhatit si sekretare, e cila më pas edhe u votua. Pas kësaj, mes palëve pati debat për mbledhjen e radhës, për të cilën nuk ishin dakord. PS-ja kërkoi që mbledhja e radhës të bëhet të hënën e ardhshme, por demokratët nuk ishin dakord. "Rregullorja është standarde, mund të kete ligji nevojë për rishikim, por nuk e kemi në tagrin për këtë. Rregullorja nuk kërkon kohë, por plani paraprak i hetimit ka nevojë për kohë. Propozoj që të vendosim dy ditë në javë që të mos kemi mundësi të justifikohemi jo ishim, jo nuk ishim. Të hënën e çdo jave të bëjmë mbledhjet e komisionit", - tha demokrati Flamur Noka. Por, me afatin një javë nuk ishte dakord Edi Paloka. "Nuk e shoh të arsyeshme, sinqerisht, një javë për të diskutuar, nuk dua të paragjykoj asgjë, as qëllimin e kërkesës për ta shtyrë një javë", - tha Paloka. Kurse socialisti Bashkim Fino u shpreh: "E para, s'ke si na paragjykon se jemi të barabartë. Duam kohë të shohim rregulloren. Komisionet e shkuara kanë kaluar edhe tri javë, por unë nuk them tri javë. Ne duam ta mbyllim sa më shpejt, edhe për tre muaj po pati mundësi. Koment të diskutimit tim nuk duhet të bëni". Por Paloka u kundërpërgjigj: "S'jam këtu të zbatoj porositë e tua, jam kryetar i komisionit për të hetuar një çështje, s'kam dëshirë t'ju bëj koment, s'ma jep ti të drejtën e fjalës mua, se e kam fituar në '90".


Komisioni hetimor për çështjen "Tahiri"

**OBJEKTI**
Në mbledhjen e ardhshme bashkë me rregulloren pritet të miratohet edhe plani i hetimit. Në një mbledhje me dyer të mbyllura që i parapriu komisionit, mes anëtarëve socialistë dhe kreut të grupit Balla është vendosur që mazhoranca të kërkojë hetimin e të gjithë fenomenit të kultivimit të kanabisit, duke u shtrirë në kohë edhe gjatë qeverisjes së demokratëve, pa u kufizuar vetëm tek Lazarati.

### "HETIMI I TAHIRIT", DEBATI NË MBLEDHJEN E KOMISIONIT

**EDI PALOKA:** Do të paraqes planin paraprak të hetimit, që do ta plotësojmë bashkërisht. Mendoj që sa më shpejt ta nisim, aq më mirë është. Unë do të propozoja që nesër pasdite të fillojmë.
**ERMONELA FELAJ:** Sot java.
**EDI PALOKA:** Sot java për një rregullore?
**ENKELJED ALIBEAJ:** Nëse është vetëm arsyeja e rregullores që të shtyhet një javë, më duket e padobishme. Që sot me njërin prej jush unë jam i gatshëm të ulemi pas mbarimit të mbledhjes dhe të detajojmë çfarëdo mospërputhjeje me rregulloren që të mos bëhemi pengesë.
**PJERIN NDREU:** Problemi është se kemi angazhime të tjera. Deri të hënën tjetër nuk jemi disponibël edhe po të duam, të hënën tjetër bëni një plan. Të gjithë jemi me aktivitete të tjera, është problemi i mbledhjes së komisionit, jo neneve të rregullores. I pjesëmarrjes sonë. Na cakto ditët dhe orët, nuk jemi në zbor, ti filozofon tani.
**EDI PALOKA:** E kemi në dorë vetë të gjejmë orën, nuk besoj se jemi të zënë nga mëngjesi në darkë.
**ENKELJED ALIBEAJ:** Të mos nxjerrim një alibi, se kam përshtypjen se do jetë një këngë që do këndohet më vonë, të mos nxjerrim alibi që jam në komisione të tjera.
**FLAMUR NOKA:** Rregullorja është standarde, mund të ketë ligji nevojë për rishikim, por nuk e kemi në tagrin për këtë. Rregullorja nuk kërkon kohë, po plani paraprak i hetimit ka nevojë për kohë. Propozoj që të vendosim dy ditë në javë, që të mos kemi mundësi për justifikime jo ishim, jo nuk ishim. Të hënave të çdo jave të bëjmë mbledhjet e komisionit.
**ERMONELA FELAJ:** Besoj se kjo kohë do të na mjaftonte që ne të vijmë me një draft të dakordësuar në mbledhjen tjetër dhe ta kalonim. Nese do të kishim edhe planin paraprak të hetimit sot nga ana juaj, do të ishte edhe më mirë. Por kjo varet nga ju. Rezerva e tretë që kam është se komisionet parlamentare në këtë periudhë janë të gjitha në fazën që janë duke dëgjuar raportimet e institucioneve të pavarura, prandaj propozimi ishte për të hënën tjetër.
**FLAMUR NOKA:** Ne mund të vendosim dy ditë në javë apo një ditë, që sot të vendosim ditët e përcaktuara. Të hënën e çdo jave në 10 apo 11 bëjmë mbledhjet e komisionit dhe vazhdojmë.
**EDI PALOKA:** Unë mendoj se nuk ka nevojë për një javë as për ta shqyrtuar dhe as për të nxjerrë një rregullore të përbashkët. Nuk e shoh të arsyeshme një javë. S'dua as të paragjykoj.
**BASHKIM FINO:** E para, s'ke si na paragjykon se jemi të barabarte. Duam kohë të shohim rregulloren, komisionet e shkuara kanë kaluar edhe tri javë, por unë nuk them tri javë. Ne duam ta mbyllim sa me shpejt, edhe për tre muaj po pati mundësi. Koment të diskutimit tim nuk duhet të bëni.
**EDI PALOKA:** S'jam këtu të zbatoj porositë e tua, jam kryetar i komisionit për të hetuar një çështje. S'kam dëshirë t'ju bëj koment, s'ma jep ti të drejtën e fjalës mua se e kam fituar në '90. Aq më tepër që jam unë këtu kryetari, nuk je ti.


Gjatë një seance parlamentare

### Berisha publikon denoncimin e 16-vjeçarit nga Kavaja

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje denoncimin e një minoreni nga Kavaja që akuzon policinë se e ka dhunuar pa shkak. Sipas Berishës, kriminelë me uniformën e narkopolicit torturojnë 16-vjeçarin. Vetë adoleshenti thotë se ka qenë në stadium duke parë ndeshjen dhe është provokuar nga një polic. Më pas sipas tij, tre policë, dy me uniformë dhe një civil e kanë rrahur në mes të rrugës. "Kriminelë me uniformën e narkopolicit torturojnë në Kavajë! Lexoni mesazhin dhe shikoni foton e të riut dixhital. 'Jam një qytetar i Kavajës dhe sot më ndodhi një gjë shumë e tmerrshme. Duke parë ndeshjen në stadium një polic po më provokonte disa herë, pastaj ndeshja mbaroi edhe duke ikur për shtëpi me një shokun tim, vijmë dy makina dhe zbresin dy policë me uniformë dhe një civil dhe filluan të më rrihnin në mes të rrugës. Jam 16 vjeç ç'është ky shtet që rreh minorenë në mes të rrugës'", tha z. Berisha.


NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURINË NR. 2/963-ND+1-43 , E LLOJIT 'APARTAMENT' , VOLUMI 55 , FAQJE 73, ZONA KADASTRALE 8513 , ME SIPËRFAQJE 67,81 M2 , NË ADRESËN : RRUGA "K. KËRTUSHA" , SHKALLA 1 , KATI 7 , DURRËS , NË PRONËSI TË SHTETASVE : Z. LUTFI GJYZELI DHE ZNJ. ENKELEJDA GJYZELI .
ÇMIMI 2.000.000 LEKË ", Data e zhvillimit të ankandit do jetë 11.04.2018 .
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 7 / 392 – G8, e llojit 'Garazhd', volumi 20 , faqe 143, zona kadastrale 8370, me sipërfaqje totale 19,94 m2, në pronësi të SHOQËRISË "IN CO" SHPK, NUIS: J62410017G, me adresë: Rruga "4 Dëshmorët", Tiranë .
ÇMIMI 2.000 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 11.04.2018
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

Pasuria nr. 109 / 229 + 3 – 6, e llojit 'Apartament', zona kadastrale 3292, volumi 24, faqe 166, sipërfaqe totale 110, 5 m2, në pronësi të AMARILDO NAÇO, me adresë : Selitë , Tiranë .
ÇMIMI 5.890.500 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 12.04.2018 .
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .



Kreu i PD zbardh emrat: Rrezik i jashtëzakonshëm, nëse nuk vihen para drejtësisë

# Basha: Narkoshteti i ka shtrirë krahët edhe në drejtësi

## "Hetim të plotë çdo zyrtari të akuzuar"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, hodhi dje akuza për drejtësi kolektive dhe paralajmëroi se aksioni i opozitës është mosheshtja, kur drejtësia nuk është e barabartë, por godet në mënyrë selektive. Sipas Bashës, nuk do të ketë drejtësi nëse nuk shkon para drejtësisë Saimir Tahiri, Vangjush Dako, Qazim Sejdini, Damian Gjiknuri etj. Kreu i PD-së pas mbledhjes së grupit parlamentar të PD-së, u kërkoi qytetarëve që t'i kërkojnë llogari drejtësisë. "Ne duam të dimë kur do të dalë Saimir Tahiri para drejtësisë, i kapur nga antimafia italiane si njeriu kyç në trafikun e drogës dhe njeriu më i afërt i Ramës. Ne duam të dimë se kur do të kapet kupola e policisë dhe të shpallurit në kërkim për drogë. Ne duam të dimë kur do të hetohet Vangjush Dako. Ne duam të dimë se kur do të dalë para drejtësisë Qazim Sejdini dhe banda ballkanike e drogës. Kur do të hetohet Damian Gjiknuri, që ka bërë pazare me banditët dhe ka blerë votat që nga Dibra e në zgjedhjet e fundit. Pa u hetuar këto raste të denoncuara me fakte flagrante, kjo do të thotë se drejtësia është e kapur dhe krimi është futur në drejtësinë. Drejtësi do të thotë kur të gjithë janë të barabartë para ligjit. Pse nuk u arrestua Elvis Roshi, për të njëjtat akuza?", deklaroi kreu i PD-së pas mbledhjes me grupin e deputetëve të PD-së. Për Bashën, këto janë çështje që nuk munden kurrsesi të harrohen, as të anashkalohen dhe as të mbulohen nga farsa apo skandale të tjera të vogla, por duhen zbardhur vënë para drejtësisë. Basha apeloi për hetim të plotë të të gjithë zyrtarëve që janë të akuzuar. Sipas tij, ai dhe PD duan të dinë se kur do të dalin përpara drejtësisë Tahiri, Qazim Sejdini dhe shumë zyrtarë të tjerë të denoncuar dhe akuzuar nga opozita. Sipas kreut të opozitës, nuk ka drejtësi pa u vënë të gjithë këta përpara drejtësisë dhe të marrin dënimin që meritojnë. "Pa u vënë këtë njerëz para përgjegjësisë, pa funksionuar drejtësia në këto raste flagrante të denoncuara me fakte nga opozita nuk ka drejtësi, por ka propagandë, ka farsë dhe kjo përbën një rrezik për vendin. Kjo do të thotë që narkoshteti i ka shtrirë dhe tentakulat e veta tek drejtësia, duke pamundësuar drejtësinë e barabartë para ligjit për këdo, duke mbrojtur dhe fshehur përgjegjësitë penale të njerëzve me pushtet dhe pushtetarëve të lidhur me krimin", u shpreh z.Basha. Ai kërkoi nga qytetarët në mbarë vendin që të kërkojnë llogari se çfarë po bën drejtësia me zyrtarët e korruptuar. "Ne kemi një mesazh për të gjithë qytetarët: Mos harroni, mos heshtni, kërkoni llogari se çfarë po bën drejtësia për çështjet kapitale në vend! Këto janë çështje që ne s'mund t'i lëmë të harrohen, të anashkalohen dhe të mbulohen nga farsa dhe skandale të tjera të vogla, të cilat absolutisht duhen zbardhur. Por një gjë të jetë e qartë, pa u vënë këta njerëz para drejtësisë, pa funksionuar drejtësia, ka vetëm propagandë dhe kjo përbën rrezik të jashtëzakonshëm për vendin", u shpreh kreu i PD. Për masën e arrestit të kryebashkiakut të Lezhës, Fran Frrokaj, ai tha se drejtësia duhet të jetë e barabartë për të gjithë.



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

**THIRRJA**
"Pa u vënë këta njerëz para përgjegjësisë, pa funksionuar drejtësia në këto raste flagrante nuk ka drejtësi, por vetëm propagandë, farsë dhe përbën rrezik të jashtëzakonshëm për vendin. Do të thotë që narkoshteti i ka shtrirë tentakulat te drejtësia duke mbrojtur e duke fshehur përgjegjësitë penale të njerëzve në pushtet", tha z.Basha.

## Konstituohet KED, merr në dorëzim dosjet e kandidaturave për Kushtetuesen

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi zhvilloi dje mbledhjen e tij të parë që prej votimit në parlament, edhe pse anëtarët e këshillit nuk kanë përfunduar ende procesin e vetingut. Objekt i punimeve të kësaj mbledhjeje që zgjati për katër orë me radhë ishte konstituimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, marrja në dorëzim e dokumentacionit mbi kandidaturat që kanë aplikuar për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese, si dhe ngritja e një grupi pune për hartimin e rregulloreve për funksionimin e këtij këshilli. Grupi i punës do të përbëhet nga Artan Broci, Altina Xhoxhaj dhe Vitore Tusha. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi autorizoi kryetarin e tij, Broci, për të bashkëpunuar gjatë këtij procesi edhe me përfaqësues të misioneve ndërkombëtare që asistojnë sistemin e drejtësisë në Shqipëri si EURALIUS etj., duke vlerësuar maksimalisht kontributin dhe asistencën e çmuar që kanë dhënë këto misione gjatë fazës së hartimit dhe implementimit të procesit të reformës në drejtësi. Mbledhja e djeshme u zhvillua edhe në praninë e Avokatit të Popullit, Erinda Ballanca, përfaqësuesve të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut Ulsi Manja dhe Enkeled Alibeaj, përfaqësuesit të Institucionit të Presidencës, Bledar Dervishaj si dhe përfaqësuesit të kryetarit të Kuvendit, Genc Gjonçaj. Janë 32 kandidatë në garë për të dyja vendet vakante në Gjykatën e Kushtetuese. Lista e emrave është dorëzuar nga presidenti, ndërkohë dhe parlamenti ka hapur procedurën për plotësimin e një vendi vakant në Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit, prej disa muajsh funksionon me 6 anëtarë nga 9 që duhet të ketë.



Gjykata Kushtetuese



## PD, Bylykbashi: Dako, si banaliteti i së keqes

Deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi akuzon kryebashkiakun e Durrësit për gjendjen ku ndodhet qyteti. Ai bën përgjegjës Dakon për situatën e rëndë që ka nisur nga mëngjesi i djeshëm, ku uji ka përmbytur rrugët dhe banesat në shumë zonat të qytetit bregdetar. "Rëndësi ka reagimi qytetar, që bëhet me votë, jo me llafe kafenesh. ?Partitë bëjnë pjesën e tyre qytetare. Por, Dako dhe masteri i tij në Tiranë, Edi Rama do vazhdojnë sa kohë durrsakët do të vazhdojnë të pranojnë banalitetin ordiner të së keqes dhe do kujtohen vetëm në kafene, duke share e përfolur të gjithë (madje më mirë opozitën, se Dakos mund t'i duhet t'i kërkojmë ndonjë leje për karusel tek 'Vollga', që punon me korrentin falas të shtyllës së elektrikut), ose kur të fillojnë emrat për kandidatët për kryetar bashkie apo deputete. Deri atëherë, në Durrës do të 'mbretërojë' banaliteti i së keqes së administrimit ordiner të Dakos", shprehet z.Bylykbashi.

**NARD NDOKA**
Kreu i PDK, deputeti Nard Ndoka shpërtheu dje në akuza kundër kryeministrit Rama, duke thënë se qeveria dhe ai "jo vetëm kanë braktisur, por edhe po shantazhojnë bashkitë që drejtohen nga opozita, konkretisht në Shkodër dhe Lezhë. Zot na ruaj nga kjo racë e keqe!", shprehet z.Ndoka.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

**A.** Automjetit tip 'SKODA', ngjyrë 'GRI', vit prodhimi '2009', nr. shasie TMBDG41U4A8840601, me targë 'TR 2338 T' , në pronësi të dorëzanësit z. ALKET Suad KOTONI, ÇMIMI 120.000 LEKË ;
**B.** Automjetit tip 'HYUNDAI', ngjyrë 'GRI', vit prodhimi '2009', nr. shasie MALAM51CBAM416803, me targë 'AA 714 BH' , në pronësi të dorëzanësit znj. AIDA Luan KOTONI , ÇMIMI 130.000 LEKË .
**Data e zhvillimit të ankandit do jetë 21.03.2018 .**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866**

Lihen të lirë edhe 9 zyrtarë të tjerë. Në burg, juristi i bashkisë dhe hartografi i hipotekës

# Skandali i pronave, lirohet kryebashkiaku i Lezhës

## Gjykata vendos "Arrest shtëpie" dhe mbikëqyrje elektronike për Frrokajn

LEZHË

Pak ditë pas superoperacionit "Ranishtja 4", ku u arrestuan dhe u ndaluan 12 persona dhe 11 të tjerë u shpallën në kërkim në lidhje me skandalin e pronave në zonën "Rana e Hedhun" në Shëngjin, Gjykata e Shkallës së Parë e Lezhës ka liruar kryebashkiakun Fran Frrokaj dhe 9 zyrtarë të tjerë të bashkisë dhe hipotekës. Ndërsa ka lënë në burg 2 zyrtarë të tjerë. Gjatë seancës gjyqësore maratonë, togat e zeza të Lezhës ka bërë rivlerësimin e masës së sigurisë duke vendosur "Arrest shtëpie" nën mbikëqyrje elektronike për Frrokajn, i cili akuzohet për veprën penale "Shpërdorim detyre". E njëjta masë sigurie është dhënë edhe për 9 të tjerë. Ndërkaq, gjykata ka lënë në qeli 29-vjeçarin Adenis Haxhia, me detyrë jurist pranë Bashkisë së Lezhës dhe 28-vjeçarin Enkelejd Zefi, me detyrë specialist hartograf pranë ZVRPP Lezhë. Pas operacionit të bujshëm, burime nga policia bënë me dije se zyrtarët lokalë në bashkëpunim me njëri-tjetrin, duke abuzuar me detyrën kanë falsifikuar, tjetërsuar dhe përvetësuar 234,548 m2 tokë shtetërore ranishte në zonën bregdetare të Shëngjinit. Sipas bluve, kjo sipërfaqe është shndërruar me dokumente të falsifikuara nga tokë shtetërore në bregdet, në tokë arë dhe pemtore.

**GJYQI**

Nën masa të rrepta sigurie u zhvillua dje seanca gjyqësore për rivlerësimin e masës së sigurisë ndaj kryetarit të Bashkisë së Lezhës, Fran Frrokaj dhe nënkryetarin e bashkisë, Enver Hafizi; kreun e këshillit të qarkut, Gjok Ndoka dhe personave të tjerë që përfunduan në pranga për skandalin e pronave në Shëngjin. Kryebashkiaku ka hyrë me pranga në sallën e gjyqit, ndërsa dhjetëra qytetarë e mbështesnin jashtë godinës së gjykatës. Gjatë seancës, Frrokaj në vend që të mbrojë veten para gjyqtarëve për akuzën që i është atashuar nga prokuroria, ka kërkuar të merren masa për rrëshqitjet e dherave në rrugën e Kalasë në qytetin e Lezhës. Ai i ka kërkuar nënkryetares së Bashkisë Lezhë t'i dërgojë një shkresë komitetit të emergjencave që të ndërhyhet në këtë rrugë, pasi ka rrëshqitje masive. Vendimi për lirimin e qytetarit të parë të Lezhës është pritur me ovacione nga të afërmit dhe mbështetësit e tij, të cilët brohorisnin "rroftë drejtësia"!. Ata kishin tri ditë që protestonin para Drejtorisë së Policisë së Lezhës. Në vendimin e gjykatës thuhet se kreu i bashkisë, Fran Frrokaj dhe zyrtarët e tjerë vendorë nuk mund të komunikojnë me persona të tjerë, përveç familjarëve që jetojnë me ta. Të vetmit që do të qëndrojnë në burg janë juristi i bashkisë, Adenis Haxhia dhe hartografi i hipotekës, Enkelejd Zefi. Në këtë seancë nuk është paraqitur kryetari i Këshillit të Qarkut të Lezhës, Gjok Ndoka, një nga të arrestuarit për tjetërsim të pronave tek "Rana e Hedhun". Për shkak të problemeve shëndetësore me zemrën, Gjok Ndoka, xhaxhai i ish-deputetit socialist Arben Ndoka ishte në spital për të marrë trajtim mjekësor.





Gjyqi i djeshëm në Lezhë

**GJOK NDOKA**

Kryetari i Këshillit të Qarkut të Lezhës, Gjok Ndoka, një nga të arrestuarit për tjetërsim të pronave tek zona "Rana e Hedhun" në Shëngjin nuk ka qenë i pranishëm në seancën e djeshme gjyqësore. Për shkak të problemeve shëndetësore me zemrën, Gjok Ndoka, xhaxhai i ish-deputetit socialist Arben Ndoka ndodhej në spital për të marrë trajtim mjekësor. Rivlerësimi i masës së sigurisë ndaj tij është bërë në ambientet e spitalit. Ndaj tij është caktuar masa e sigurisë "arrest shtëpie".

LEZHE

### Babai i Arta Markut nuk ka punuar në Bashkinë e Lezhës

Pas arrestimit të kryebashkiakut Fran Frrokaj me akuzën e grabitjes së pronave përmes tjetërsimit dhe falsifikimit të dokumenteve, në mediat 'online' prej ditës së djeshme po qarkullon një lajm që babai i kryeprokurores Arta Marku punon pranë Bashkisë së Lezhës, si inxhinier në një nga ndërmarrjet e institucionit. Por, zyra e shtypit të kryeprokurores sqaron se, "në fakt, babai i Prokurores së Përgjithshme, Ndrec Marku, nuk ka punuar ndonjëherë në Bashkinë e Lezhës. I ati i Prokurores së Përgjithshme ka qenë me profesion teknik i mesëm miniere dhe jo inxhinier. Madje, ai është në pension prej shumë vitesh dhe nuk ka ndonjë të dhënë për të treguar përçarje mes njerëzve apo mes lezhjanëve", shkruhet në njoftim.



**MBËSHTETËSIT E FRROKAJT**

"Vendimi për lirimin e qytetarit të parë të Lezhës është pritur me ovacione nga të afërmit dhe mbështetësit e tij, të cilët brohorisnin "rroftë drejtësia". Ata kishin tri ditë që protestonin para Drejtorisë së Policisë së Lezhës.

**VENDIMI I PLOTË I GJYKATËS**

**1.** Pranimin pjesërisht të kërkesës.
**2.** Verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal "Arrest në burg" të dhënë ndaj të arrestuarit Fran Frrokaj me vendimin nr.86, datë 15.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe zëvendësimin e kësaj mase me atë të "Arrest në shtëpi" me mbikëqyrje policore, duke urdhëruar të dyshuarin Fran Frrokaj të mos largohet nga banesa e tij në qytetin e Lezhës, lagjja "Besëlidhja" dhe të mos komunikojë me persona të tjerë me përjashtim të atyre që bashkëjetojnë me atë.
**3.** Verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal "Arrest në burg" të dhënë ndaj të arrestuarit Enver Hafizi me vendimin nr.86, datë 15.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe zëvendësimin e kësaj mase, me atë të "Arrest në shtëpi" me mbikëqyrje policore, duke urdhëruar të dyshuarin Enver Hafizi të mos largohet nga banesa e tij në qytetin e Lezhës, lagjja "Besëlidhja" dhe të mos komunikojë me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që bashkëjetojnë me atë.
**4.** Verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal "Arrest në burg" të dhënë ndaj të arrestuarit Gjok Ndoka me vendimin nr.86, datë 15.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe zëvendësimin e kësaj mase, me atë të "Arrest në shtëpi" me mbikëqyrje policore, duke urdhëruar të dyshuarin Gjok Ndoka të mos largohet nga banesa e tij në qytetin e Lezhës dhe të mos komunikojë me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që bashkëjetojnë me atë.
**5.** Verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal "Arrest në shtëpi" të dhënë ndaj të arrestuarës Gjelina Bacaj me vendimin nr.86, datë 15.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe vazhdimin e zbatimit të kësaj mase.
**6.** Verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal "Arrest në burg" të dhënë ndaj të arrestuarit Dilaver Neli me vendimin nr.86, datë 15.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe zëvendësimin e kësaj mase, me atë të "Arrest në shtëpi", duke urdhëruar të dyshuarin Dilaver Neli, të mos largohet nga banesa e tij që ndodhet në Mamurras, Bashkia Kurbin.
**7.** Verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal "Arrest në burg" të dhënë ndaj të arrestuarit Ardenis Haxhia me vendimin nr.86, datë 15.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe vazhdimin e zbatimit të kësaj mase.
**8.** Verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal "Arrest në burg" të dhënë ndaj të arrestuarit Enkelejd Zefi me vendimin nr.86, datë 15.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe vazhdimin e zbatimit të kësaj mase.
**9.** Verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal "Arrest në shtëpi" të dhënë ndaj të arrestuarit Frrok Frroku me vendimin nr.86, datë 15.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe vazhdimin e zbatimit të kësaj mase.
**10.** Verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit personal "Arrest në burg" të dhënë ndaj të arrestuarit Pjetër Gjoni (Lini) me vendimin nr.86, datë 15.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe zëvendësimin e kësaj mase, me atë të "Arrest në shtëpi", duke urdhëruar të dyshuarin Pjetër Gjoni (Lini), të mos largohet nga banesa e tij që ndodhet në Mamurras, Bashkia Kurbin.
**11.** Ngarkohet Prokuroria e rrethit gjyqësor Lezhë për ekzekutimin e këtij vendimi.
**12.** Kundër këtij vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër brenda 5 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes.

TAKSAT E SHTEPIVE
KATEGORITE

Qeveria merr në "mbrojtje" 10 kategori në nevojë, i përjashton nga skema

# Taksa e shtëpisë, pensionistët që përjashtohen nga detyrimi

## *Përfitojnë edhe objektet e kultit dhe hotelet me 4 e 5 yje*

Ornela Manjani

Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët dhe ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike janë dy prej dhjetë kategorive që përjashtohen nga taksa e shtëpisë, e cila hyn në fuqi në 1 prill.

**KATEGORITË**

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesën, shtëpinë, 10 kategori. Të përjashtuara nga detyrimi janë ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët; ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike; banesat sociale, objektet e kultit dhe ato që u shërbejnë klerikëve etj. Ndërkohë të gjitha ndërtesat e tjera do të taksohen mbi vlerën e tregut në tri shkallë. Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është: a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim; b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike; c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi. Këto janë ndryshimet në ligjin për taksat vendore, i cili hyn në fuqi në fillim të vitit të ardhshëm. Ligji është botuar dje në Fletoren Zyrtare dhe parashikon se taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

**NDËRTIMET PA LEJE**

Me ndryshimet ligjore është parashikuar që taksës për ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje". Sipas ligjit taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

**MBLEDHJA E TAKSËS**

Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat. Njësitë administrative kryejnë: a) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale; b) përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale); c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën; ç) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj.; d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve. 2. Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mblidhet nëpërmjet agjentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave. 3. Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me ligjin "Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.".



Foto ilustruese

**SHKALLA E TAKSËS**

- Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

**a)** 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
**b)** 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
**c)** 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

**PËRJASHTOHEN NGA TAKSA MBI NDËRTESAT:**

**1)** pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
**2)** pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
**3)** ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të pa liberalizuara;
**4)** banesat sociale në pronësi të bashkive;
**5)** pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
**6)** ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
**7)** strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
**8)** ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
**9)** ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
**10)** ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore".

## Grupet që taksohen dhe vlera e pasurisë

Taksapagues është çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Vlerë e pasurisë është vlera aktuale e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore e njohur me dokumente ligjore, ose vlera e përcaktuar me një nga metodat e përshkruara në këtë metodologji. Vlera e pasurisë është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore. Ndërsa "veprimtari ekonomike", konsiderohet çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm.



Eksportet shqiptare u rritën me afro 19% gjatë muajit shkurt, duke përmirësuar lehtë bilancin tregtar të vendit krahasuar me vitin e kaluar. Sipas Institutit të Statistikave, deficiti tregtar u ngushtua me 8% krahasuar me shkurtin 2017. Megjithatë, ecuria e mirë e eksporteve vetëm sa ngushtoi disi shifrat e janarit dhe për dy muajt e parë të vitit, ekonomia akumuloi rreth 43 miliardë lekë deficit në këmbimet tregtare, rreth 7% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Për dy muajt e parë të vitit, eksportet arritën në 47.4 miliardë lekë, 21% më shumë kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë. Edhe për vitin 2018 eksportet duket se do të udhëhiqen nga sektori i fasoneve. Sipas INSTAT, eksportet e grupit "tekstile dhe këpucë" për dy muajt e parë të vitit vazhdojnë të dominojnë strukturën e eksporteve me rreth 43% të totalit, peshë kjo e ngjashme me vitin 2017. Grupi "materiale ndërtimi dhe metale" u shfaq në rritje, duke arritur një vlerë prej 8.7 miliardë lekësh, 58% më shumë krahasuar me dymujorin e vitit 2017. Rritje pozitive për momentin vërehet edhe në eksportet e mineraleve dhe të produkteve ushqimore. Importet e mallrave vijuan rritjen edhe gjatë muajit shkurt, por me ritme më të ngadalta. Për dy muajt e parë të vitit importet u zgjeruan 14% me bazë vjetore. Shumica e grup-mallrave rezultojnë në rritje, ndërsa në krye të importeve për nga vlera ngelet grupi "materiale ndërtimi dhe metale". Dominimi i mallrave kapitale në strukturën e importeve tregon se ecuria e investimeve në ekonomi duket të jetë e kënaqshme edhe në muajt e parë të këtij viti.



**Eksportet shqiptare u rritën 19% gjatë muajit shkurt**

# Tregtia e jashtme, bie deficiti, eksportet rriten me 19%

---

Kreditimi për ndërtimin, Shkodra me uljen më të madhe, Tirana me rritje

Ornela Manjani

# Bankat ulin normat e interesit për kredi për shtëpi

## *Norma mesatare e interesit zbret në 7%*

Normat e interesit për kreditë në lekë për individë kanë shënuar rënie të lehtë në tremujorin e katërt të vitit, duke zbritur sërish në nivelet më të ulëta të tyre të shënuara në pjesën e dytë të vitit të kaluar. Kështu, norma mesatare e interesit shënoi 7.0%, nga 7.3% në dy tremujorët e mëparshëm dhe 7.5% në tremujorin e parë të vitit. Reduktimi i lehtë i normave në këtë tremujor është diktuar kryesisht nga interesat e kredive për banesa dhe ato për konsum, të cilat rezultuan përkatësisht 3.9% dhe 7.7%. Ndërkohë, norma e interesit për kreditë overdraft është shfaqur e qëndrueshme, në 11.2%. Të dhënat bëhen të ditura nga Banka e Shqipërisë në raportin për tendencat e kreditimit. Ndërkohë, kryeqyteti ka nivelin më të lartë të kreditimit për sektorin e ndërtimit, ndërsa Shkodra ka pasur më pak, kjo sipas BSH. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se në tremujorin e fundit të 2017-ës në Tiranë janë dhënë rreth 3.4 mln lekë më shumë për ndërtim dhe blerje banesash. Ndërkohë sipas INSTAT, vitin e kaluar janë miratuar gjithsej 819 leje nga ku vendin e parë e mban Tirana me 106 leje më shumë krahasuar me vitin 2016. Pas Tiranës, qytetet që janë mbështetur më shumë me hua për ndërtim janë Durrësi, Korça dhe Vlora. Shkodra është qyteti me nivelin më të ulët të kreditimit sipas Bankës së Shqipërisë. Të dhënat tregojnë se në tre muajt e fundit të vitit të kaluar, qyteti verior ka marrë rreth 1 mln kredi më pak në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.




[7] Kredia konsumatore ka kontribuar me rreth 86% në zgjerimin tremujor të kredisë për individë.
[8] Kredia konsumatore zë 31% të kredisë për individë, ose vetëm 10% të kredisë totale.

**KREDIA**

Kredia për individë ka shfaqur norma të larta rritjeje edhe në tremujorin e katërt të vitit, e mbështetur si nga kushtet më të lehtësuara të kreditimit, ashtu edhe nga një kërkesë në rritje nga ky segment. Zhvillime pozitive gjatë kësaj periudhe vërehen si në kreditë konsumatore, ashtu edhe në kreditë për banesa. Paralelisht, rritja e shpejtë e kreditimit në lekë ka përkrahur zhvendosjen e mëtejshme të këtij portofoli drejt monedhës vendase. "Kredia për individë ka shfaqur norma të larta rritjeje edhe në tremujorin e katërt të vitit, e mbështetur si nga kushtet më të lehtësuara të kreditimit, ashtu edhe nga një kërkesë në rritje nga ky segment. Zhvillime pozitive gjatë kësaj periudhe vërehen në të dyja segmentet kryesore të saj. Gjatë këtij tremujori, normat e interesit të kredisë në lekë për individët kanë shënuar rënie të lehtë, ndërsa interesi për kreditë në euro ka mbetur i pandryshuar. Pjesa më e madhe e kushteve të kreditimit për individët janë në kahun lehtësues. "Për tremujorin e parë të vitit 2018, bankat presin të shtrëngojnë standardet e kreditimit për individë", - thuhet në raportin e Bankës së Shqipërisë. Sipas raportit mësohet se portofoli i kredisë për individë ka vijuar të mbajë ritme të larta rritjeje, duke mbështetur edhe rritjen e kredisë për sektorin privat. Në tremujorin e katërt ky portofol u rrit me 2 miliardë lekë. Zhvillimet pozitive në portofolin e kredisë për individë janë mbështetur nga kredia konsumatore, në tremujorin e katërt të vitit. Normat e rritjes së këtij portofoli u përshpejtuan në 12.9%, më të larta se në tremujorin e tretë. Kjo rritje dyshifrore reflekton si dominimin e këtij portofoli nga monedha vendëse, ashtu edhe peshën e ulët të tij. Karakteristikë e vitit 2017 është rritja në mënyrë të qëndrueshme e portofolit në fjalë, duke ndikuar edhe në rritjen e peshës së tij me 1.7 pp gjatë vitit. Gjithashtu, dominimi i kredisë në lekë (84%) në këtë portofol faktorizon një rol më të ulët të mbiçmimit të lekut ndaj valutave kryesore. Ecuria e mirë e kredisë konsumatore në dy vitet e fundit është mbështetur si nga lehtësimi i kushteve të financimit nga banka, ashtu edhe nga kërkesa në rritje e individëve për të.

United Nations Development Programme

UNDP
Empowered lives. Resilient nations.

**TENDER ANNOUNCEMENT**

**Subject: – the “RFP for Compliance with the requirements of High State Control Institution (HSC)” for STAR 2 Project**

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 44905**

**RFP for “Assessment on level of adoption and impact of Standard of Operating Procedures at Municipal Level in Albania” for STAR 2 Project**

**For more details please refer to the link below:**
http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/

**Relevant dates:** All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 29 March 2018

**Address for communications:**
Email: procurement.al@undp.org
**Or**
Str. “Skenderbej”, Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
Tirana, Albania

United Nations Development Programme

UNDP
Empowered lives. Resilient nations.

**VACANCY ANNOUNCEMENT**

The UNDP office in Albania is looking for a qualified candidate who could fill the following vacancy.

| | |
|---|---|
| *Post Title:* | *STAR2 Consultant on IT Service and Transparency* Innovation -Framework Agreement |
| *Duty station:* | *Tirana* |
| **Duration of Assignment:** | Up to 150 working days during the period April 2018 – June 2019 |
| **Type of Contract:** | Individual Contract |
| **Educational Background:** | Advanced degree in Business and IT, Computer Science, or related fields |
| **Work Experience** | At least 7 years of experience in developing databases, or providing IT services to a public or private sector; Knowledge on database implementation and relational archives; Knowledge of Reporting Tools such as Business Intelligence and/or other Reporting Systems; Knowledge of web development tools for database access; Deep knowledge of web-based development frameworks; Fully computer literacy; Participation in the last 3 years in projects related to the implementation of databases (extensive use of IT solutions |
| **Tentative Starting Date:** | 09 April 2018 |
| **Deadline for Application:** | 30 March 2018 |
| Job Description: | **Available at UNDP site:** http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/ |

Interested and qualified candidates are requested to submit their application online only (available at http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/jobs/). Incomplete applications will not be considered. Only short-listed candidates will be notified.

Ngjarja në 2016, 40-vjeçari u rrëmbye dhe u gjet i vrarë në Murqinë të Krujës

# Ekzekutimi i Çollakut, burg përjetë për Denis Shtrazën

## Gjyqi, avokati Neshat Fana kërkoi pafajësi

Ina Allkanjari

Gjykata e Krimeve të Rënda zhvilloi ditën e djeshme seancën gjyqësore për caktimi masën e sigurisë për të pandehurin Denis Shtraza. Nën akuzën e rrëmbimit, torturës e më pas vrasjes së shtetasit Gazemend (Laert) Çollaku, trupi gjykues i kryesuar nga Ardit Mustafaj, shpalli fajtor Shtrazën duke e dënuar me burgim të përjetshëm. Të njëjtin dënim kishte kërkuar për të pandehurin edhe prokuroria në seancën e mbajtur më 17 nëntor të vitit të shkuar.

**SEANCA GJYQËSORE**

Procesi gjyqësor ndaj Denis Shtrazës gati për një periudhë 14 mujore. Ditën e djeshme ai u njoh me masën e sigurisë "Burg për jetë". Krimet e rënda e shpallën fajtor, për akuzën e rrëmbimit dhe vrasjes së Gazmend Çollakut. Për shkak se viktima pas torturave është qëlluar me plumb në kokë, gjykata e dënoi të pandehurin edhe për armëmbajtje pa leje. Nëpërmjet avokatit mbrojtës, Neshat Fana, Shtraza kërkoi pafajësi. Ndryshe nga organi i akuzën, ku në seancën e mbajtur në 17 nëntor të 2017 kërkoi burgim të përjetshëm për Shtrazën. Në arsyetimin e vendimit, gjykata thekson te faktin se gjurmët e gjakut e gjetura në makinën në pronësi të Ervin Dalipaj, ishoficerit të ekzekutuar në një atentat mafioz në Durrës vitin e kaluar, janë të viktimës Gazmend Çollaku. Për faktin se Denis Shtraza është ndaluar pak orë pas ngjarjes, duke udhëtuar me Dalipajn me makinën ku u gjetën njollat e gjakut të viktimës, gjykata ka krijuar bindjen se ai është një prej autorëve të rrëmbimit dhe më pas vrasjes së 40-vjeçarit. Gjithashtu, sipas gjykatës rezulton e provuar që viktima nuk kishte njohje me Dalipajn dhe nuk ekziston asnjë mundësi që ai të ketë udhëtuar me makinën "Mercedez Benz". Mendohet se njollat e gjakut mund të kenë mbetur në automjet, nga kontakti direkt i viktimës me automjetin, çka do të thotë se trupi i pajetë i tij është transportuar me makinën në pronësi të Dalipajt, ose janë lënë nga ndonjë mjet i fortë me të cilin është goditur Gazmend Çollaku. Më datë 06.01.2016, në lagjen Nr.1 në Durrës, 4 persona, 3 prej të cilëve me jelekë dhe mbishkrimin "Policia", kanë marrë me forcë duke e futur në mjetin e tyre tip "Audi A6" me ngjyrë të zezë shtetasin Gazmend Çollaku 40-vjeç, banues në Durrës. Ai u gjet i pajetë në Murqinë të Krujës. Rrëmbyesit e kishin torturuar 40-vjeçarin dhe lidhur këmbë e duar. Prokuroria për Krime të Rënda dërgoi për gjykim shtetasin Denis Shtraza për këtë ngjarje, i akuzuar për veprat penale "Rrëmbimin ose mbajtjen peng të personit" e paraprirë ose e shoqëruar me tortura fizike dhe kur është shkaktuar vdekja e tij", si dhe "Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake". I pandehur së bashku me Shtrazën ishte dhe Ervin Dalipaj, por gjykimi ndaj tij u pushua pasi ai u ekzekutua në një atentat mafioz në aksin Maminas-Durrës, mesditën e 25 prillit 2017.



Denis Shtraza, në sallën e gjyqit

**VENDIMI**

Krimet e Rënda e shpallën fajtor Denis Shtrazën, për akuzën e rrëmbimit dhe vrasjes së Gazmend Çollakut. Për shkak se viktima pas torturave është qëlluar me plumb në kokë, gjykata e dënoi të pandehurin edhe për armëmbajtje pa leje. Nëpërmjet avokatit mbrojtës, Neshat Fana, Shtraza kërkoi pafajësi.

---

### Reforma në burgje, Gjonaj: 130 punonjës të policisë me rekorde penale

Ministrja e Drejtësisë Etilda Gjonaj ka deklaruar ditën e djeshme se reforma në sistemin e burgjeve do të nisi me verifikimin e pastërtisë ligjore dhe morale të punonjësve. Gjonaj ka bërë të ditur shifrat, ku rreth 130 punonjës të policisë së burgjeve janë konstatuar me rekorde penale, 70 punonjës në papajtueshmëri me arsimin në vendin e punës. Ndërkaq në kuadër të forcimit të masave dhe kontrolleve në burgje në 6 muaj, 65 punonjës janë proceduar penalisht dhe 40 punonjës janë propozuar për masa administrative. Në kuadër të reformës në burgje, ministrja e Drejtësisë u shpreh se "verifikimi i pastërtisë morale të punonjësve të sistemit të burgjeve, është hapi i parë për pastrimin e plotë të radhëve të punonjësve të burgjeve nga elementët e inkriminuar". Gjonaj deklaroi se do largohen nga sistemi i burgjeve punonjësit e policisë me rekorde penale, të cilët nuk duhet të ishin pranuar në sistemin e burgjeve. Po ashtu të gjithë ata punonjës që janë në papajtueshmëri të arsimit me vendin e punës do largohen ose do përshtaten me arsimin në vendin e punës.

---

Reshjet, qyteti i Durrësit kthehet në "Venecia"

# Përkeqësohet situata në qarkun e Shkodrës, nën ujë 2520 ha tokë dhe 155 banesa

**SHKODËR** - Rëndohet situata e përmbytjeve në Shkodër. Sipas informacioneve nga autoritetet lokale, por edhe nga Ministria e Mbrojtjes ka rritje të sipërfaqes së tokës nën ujë. Ndërkohë që në të gjithë territorin e saj vazhdojnë reshjet e shiut. Sipas burimeve nga Ministria e Mbrojtjes, në qarkun e Shkodrës janë përmbytur rreth 2520 ha tokë. Ndërsa, 155 banesa janë nën ujë. Konkretisht në njësinë administrative Bushat, Bashkinë Vau-Dejës ka pasur rreth 390 ha tokë të përmbytur. Në Bashkinë Shkodër, nëzonën e Livadeve janë përmbytur 60 ha. Në këtë lagje ndodhen mbi 40 banesa me prezencë uji afër oborreve të tyre dhe nga këto 4 familje mbajnë bagëti, ku si pasojë e fushave të përmbytura paraqiten vështirësi në sigurimin e ushqimit për to. Familjet e këtyre banesave furnizohen me ujë të pijshëm nëpërmjet puseve dhe ky paraqitet si problem. Në lagjen 'Ajasëm' janë rreth 80 dynymë tokë e mbuluar nga uji dhe si pasojë 5 familje të kësaj lagjeje, të cilat mbajnë rreth 100 krerë bagëti, kanë vështirësi në sigurimin e ushqimit për to. Njësia Administrative Bërdicë: Ka pasur rreth 290 ha tokë të përmbytura. Njësia Administrative Dajç: Ka pasur rreth 780 ha tokë të përmbytur pasi niveli i ujit ka pësuar rritje me rreth 12 cm. Në lagjen Zadrimë, Marinaj dhe Maçit, të fshatit Shirq, kanë qenë të izoluara nga prezenca e ujit 20 familje dhe në fshatin Mushan 5 familje. Kërkohet të ndërhyhet për lartësimin e argjinaturës së Pentarit në rreth 300 ml gjatësi. Njësia Administrative Ana e Malit: Ka pasur rreth 1200 ha tokë të përmbytur (fshati Muriqan 420 ha, fshati Oblikë 580 ha dhe fshati Obot 200 ha), pasi niveli i ujit ka pësuar rritje me rreth 20 cm. Në fshatin Obot kalimi është bërë vetëm me automjete të kalueshmërisë së lartë dhe me varka e gomone. Ujësjellësi Oblika 1 vazhdon të jetë jashtë funksionit si pasojë e përmbytjeve. Bashkia Shkodër ka vazhduar me 2 mjete autobote furnizimin e banorëve me ujë të pijshëm. Njësia Administrative Rrethina: Ka pasur rreth 60 ha tokë të përmbytur. Njësia Administrative Guri i Zi: Ka pasur rreth 5 ha tokë të përmbytur. Gjithsej, në Bashkinë Shkodër janë rrethuar nga uji rreth 155 banesa prej të cilave: 70 banesa në fshatin Obot, 15 banesa në fshatin Gorricë, 15 banesa në fshatin Shirq, 15 banesa në fshatin Mushan dhe 40 banesa në zonën e Livadheve.

**DURRËS**

Qyteti i Durrësit dje ngjante me Venecian. Reshjet e dendura të shiut kanë përmbytur rrugët e këtij qyteti, ndërsa në zonën e ish-Kënetës, uji ka arritur deri në 1.5 metra. Situata në këtë qytet dhe konkretisht në shëtitoren "Taulantia", rrugën "Aleksandër Goga", zona te stadiumi, te stacioni i trenit, lagja nr.13, Shkozeti, etj. Në Currila ka rrëshqitje dherash ndërsa rruga e pakalueshme.



Përmbytjet në Shkodër



Përmbytjet në Durrës

**ZËVENDËSKRYEMINISTRJA**

Situata e rëndë e krijuar nga reshjet ka dërguar dje në Shkodër zëvendëskryeministren Senida Mesi. Gjatë inspektimit në njësinë administrative të Dajçit, ajo garantoi banorët se qeveria shqiptare do të marrë masat e nevojshme për evidentimin, vlerësimin dhe minimizimin e dëmeve të shkaktuara nga kjo fatkeqësi natyrore. Ndërkaq, zëvendëskryeministrja tha se dje u dërguan në Shkodër 20 tonë ushqime për gjënë e gjallë.

---

BULQIZË

### Atentat me armë 2 vëllezërve, në kërkim 19-vjeçari

Një atentat me armë zjarri ka ndodhur dje në Bulqizë, të cilit i kanë shpëtuar mrekullisht dy vëllezër. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ngjarja ka ndodhur rreth orës 10:20, në rrugën e pazarit, Qytet i Vjetër Bulqizë. Mësohet se si pasojë e një konflikti është qëlluar me armë zjarri në drejtim të automjetit tip "Opel", ku udhëtonin dy shtetasit E.M. dhe E.M., banues në Bulqizë, pa shkaktuar dëmtime në njerëz. "Falë veprimeve të shpejta dhe profesionale të kryera nga shërbimet e policisë, ka rezultuar se autori i dyshuar i kësaj ngjarje është shtetasi Elidon Tançi, 19 vjeç, banues në Bulqizë, i proceduar më parë nga Policia për veprën penale "Dëmtime tjera me dashje", po për konflikt, i cili është shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e tij. Grupi hetimor vijon hetimet për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të ngjarjes, si dhe po hetohet nëse ka persona të tjerë të implikuar në këtë ngjarje", thuhej ndër të tjera në njoftimin e policisë.

Trafiku Shqipëri-SHBA, dalin para gjykatës për masën e sigurisë 39 të arrestuarit

# Dekonspiroi operacionin për klandestinët, bie në pranga polici

## *Adriatik Bakiasi dyshohet se njoftoi trafikantët për arrestimet*

Një oficer policie ka përfunduar në pranga mbrëmjen e së dielës, pasi dyshohet se dekonspiroi megaoperacionin e koduar 'One if-by land', gjatë të cilit u shkatërruan shtatë grupe kriminale që kontrabandonin shtetas shqiptarë drejt Anglisë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Kanadasë. Konkretisht Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme ka arrestuar oficerin Adriatik Bakiasi, pasi dyshohet se i ka çuar njoftim një pjese të grupit kriminal se do të arrestoheshin. Ndërkohë ditën e djeshme pranë gjykatës së krimeve të rënda është zhvilluar seanca gjyqësore për masën e sigurisë për 39 personat e arrestuar për dërgimin e paligjshëm të shtetasve nga Shqipëria në SHBA, Kanada dhe Angli. Prokurori i dosjes, Eugen Beci, kërkon lënien në fuqi dhe vazhdimin e masës së sigurisë "arrest me burg" për të arrestuarit. Mes të dyshuarve janë edhe 4 punonjës të policisë kufitare, të cilët merrnin para nga grupet kriminale dhe në këmbim nuk i kontrollonin dokumentet dhe nuk regjistronin ne sistemin TIMS personat e kontrabanduar. Po kështu mësohet se dy shtetas bullgar, të cilët janë shpallur në kërkim mundësonin infrastrukturën që realizonte falsifikimin e dokumenteve. Operacioni u finalizua para dy ditësh me lëshimin e 51 urdhërarresteve për persona të përfshirë. 39 prej tyre u arrestuan në Shqipëri, ndërsa 12 të tjerë u shpallën në kërkim. Sakaq ditën e djeshme, Policia e Shtetit ka publikuar skemën e plotë të trafikimit dhe itinerarët që këto persona ndiqnin.



Foto ilustruese

**MASA E SIGURISË**

Ditën e djeshme pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda është zhvilluar seanca gjyqësore për masën e sigurisë për 39 personat e arrestuar për dërgimin e paligjshëm të shtetasve nga Shqipëria në SHBA, Kanada dhe Angli. Prokurori i dosjes, Eugen Beci, kërkon lënien në fuqi dhe vazhdimin e masës së sigurisë "arrest me burg" për të arrestuarit.

### ARRESTIMI I OFICERIT

Mbrëmjen e së dielës Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme ka vënë në pranga oficerin e policisë Adriatik Bakiasi, pasi dyshohet se ka dekonspiruar operacionin e koduar "One if-by land". Operacion, i cili çoi në goditjen e 7 grupeve kriminale që bënin pasaporta false dhe çonin njerëz në SHBA, Kanada dhe Angli.

Operacioni u shtri në disa qytete dhe numri i të dyshuarve ishte shumë i madh, për këtë arsye SHÇBA monitoroi me shumë kujdes punonjësit e policisë, për të parandaluar nxjerrjen e sekretit. Në këtë kuadër u morën masa në terren dhe u ndryshua tërësisht i gjithë plani operacional, i hartuar deri në ato momente për arrestimin e të dyshuarve, që jetonin në disa qytete, si Tiranë, Korçë, Lezhë, Kukës dhe Dibër. Nga verifikimet e SHÇBA në bashkëpunim me policinë, rezultoi se disa prej të dyshuarve si anëtarë të organizatës kriminale, ishin informuar nga Bakiasi, se do të përfundonin në pranga. Për këtë shkak, Policia e Shtetit, e asistuar nga policitë e disa vendeve partnere, vendosi të përshpejtonte operacionin, duke bërë të mundur arrestimin e të dyshuarve.

### SKEMA E TRAFIKIMIT

Organizata kriminale, e cila dërgonte shtetas shqiptare drejt tri destinacioneve kryesore u godit pas një hetimi disa mujor nga Prokuroria për Krime të Rënda. Kundrejt pagesave të cilat varionin nga 7 mijë paund deri në 25-30 mijë dollarë, grupet kriminale, pajisnin qytetarët me pasaporta të falsifikuara të vendeve të BE-së e në këtë mënyrë, ata udhëtonin drejt destinacioneve në katër rrugë kryesore. Rruga kryesore e kalimit të qytetarëve, ishte nga Shqipëria në Itali-Francë-Meksikë e më pas në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Rruga e dytë që ndiqej ishte ajo nga vendi ynë në Malin e Zi, më pas në Serbi e Gjermani. Prej andej qytetarët udhëtonin drejt Spanjës. Nga këtu përshkonin dy rrugë. Kishte prej tyre që kalonin në Meksikë me destinacion final SHBA, ndërsa të tjerë kalonin përmes Kosta Rikës. Një rrugë tjetër e ndjekur nga trafikantët, ishte ajo e kalimit përmes Kosovës, prej andej qytetarët udhëtonin drejt Bullgarisë ose Belgjikës. Nga kjo e fundit kalonin në Republikën Domenikane e prej andej në Kanada. Ata që kalonin nga Bullgaria, udhëtonin drejt Spanjës dhe përmes Kosta Rikës hynin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Policia shqiptare bën me dije se për shkatërrimin e kësaj linje rol vendimtar kanë luajtur edhe 2 agjentët speciale të Shërbimit Diplomatik të Sigurisë së Departamentit Amerikan të Shtetit, të atashuar pranë ambasadës së SHBA-ve në Tiranë.


The European Union Delegation to Albania is looking for

**ADMINISTRATIVE ASSISTANT**

With main focus on

***Human Resources Management and Protocol Issues***

We offer

- ***Multicultural working environment***
- ***Competitive salary***
- ***Benefits by law***

**For complete information and application, please refer to:**

**https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en**

**"Jobs & Funds" > "Jobs, Internships" > "Job offers"**

**Deadline for applications: 31/03/2018**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Mirëmbajtja vjetore e sistemit Cisco Web Content"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,671,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Mirëmbajtja vjetore e sistemit Cisco Web Content "**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 11 Prill 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

### BERZH dhe Bashkia e Tiranës nënshkruajnë marrëveshjen

# Financim për Bovillën dhe linjën e re të furnizimit me ujë për 3 zona në Tiranë



Së shpejti do të dyfishohet kapaciteti i Bovillës dhe do të ndërtohet një linjë e re për furnizimin me ujë të pijshëm në zonën e Unazës së Re, Yzberishtit dhe Kasharit. Kjo falë marrëveshjes së financimit të nënshkruar ditën e djeshme mes Bashkisë së Tiranës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Tirana është autoriteti i parë lokal që përzgjidhet nga BERZH-i, duke nënshkruar një marrëveshje që mundëson dyfishimin e sasisë së filtrimit të ujit, që furnizon qytetarët e Tiranës dhe njëkohësisht, shtrirjen e një rrjeti të ri edhe në zonat e sipërpërmendura. "Mezi pres që në këtë paketë të parë të bëjmë dy investime kryesore: Së pari, zgjerimin e kapacitetit të Bovillës, që është sistemi ynë filtrues. Do dyfishojmë sasinë e ujit që filtrohet për qytetin e Tiranës. Së dyti, ky financim na mundëson një linjë të re magjistrale, nga liqeni i Bovillës direkt në zonën e Unazës së Re, Yzberishtit dhe Kasharit", deklaroi Veliaj. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, kryebashkiaku tha se ajo u dedikohet qytetarëve të Tiranës, të cilët janë treguar korrekt me detyrimet ndaj bashkisë. Ndërkaq, drejtori i BERZH-it për Shqipërinë, Matteo Colangeli, vlerësoi faktin që kjo është hera e parë që banka financon një projekt bashkie, pa mbështetjen e buxhetit të shtetit, ndërsa theksoi se investimi do të rrisë kapacitetet dhe standardin e shërbimit të UKT-së.

### Komisioni i Shëndetësisë miraton marrëveshjen për njohjen e kontributeve me Austrinë



Voltiza Duro

# Pensionet e emigrantëve, Astrit Hado: Jemi në vendnumëro

## "Mungesë e vullnetit politik nga Greqia e Italia"

Mungesa e një marrëveshjeje bilaterale mes Shqipërisë e Greqisë apo Italisë, ka bërë që periudhat kontributive të emigrantëve shqiptarë të mos njihen, e si pasojë mos të ketë një bashkim të tyre. Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, gjatë takimit të Komisionit Parlamentar të Shëndetësisë theksoi se prej një viti e gjysmë situata lidhur me këtë çështje ka ngelur në vend numëro, pavarësisht faktit që është diskutuar e janë bërë përpjekjet e nevojshme. "Fatkeqësisht situata është në vend numëro, është po njësoj siç ka qenë para një viti e gjysmë. Nga ana jonë dhe Ministrisë së Mirëqenies në atë kohë, janë bërë disa përpjekje kryesisht me Italinë, për të vendosur një komunikim për fillimin e negociatave. Gjatë vizitës që ka bërë kryeministri italian këtu, është diskutuar kjo çështje e po ashtu edhe me ministritë përgjegjëse; por fatkeqësisht kemi ngelur në të njëjtën situatë. Ka një mungesë dëshire nga ana e palës italiane dhe greke për të filluar negociatat në fushën e mbrojtjes së sigurimeve shoqërore", - tha në fjalën e tij Astrit Hado. Ky i fundit më tej bëri me dije se kjo vjen si pasojë e mungesës së vullnetit politik nga ana italiane, e jo për kostot financiare që ka një marrëveshje e tillë. "Me Greqinë ndoshta është problem financiar për shkak të krizës ekonomike që po kalon, ndërsa me Italinë nuk besoj se është një problem teknik sesa më tepër një problem politik, çka do të thotë që mungon vullneti politik nga ana italiane për të nënshkruar një marrëveshje me Shqipërinë, e kjo jo për faktin e kostos financiare që ka. Nëse e startojnë marrëveshjen me Shqipërinë, duhet të jenë të detyruar të arrijnë marrëveshje dhe me vende të tjera. Nga pikëpamja e marrëveshjes nuk ka asgjë teknike që e pengon, është thjesht mungesë vullneti politik", - theksoi më tej kreu i ISSH-së. Gjatë takimit, Komisioni i Shëndetësisë miratoi marrëveshjen për njohjen e kontributeve midis Shqipërisë dhe Austrisë, ku përfitues do të jenë rreth 2 mijë shtetas shqiptarë që jetojnë atje.



Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Astrit Hado, gjatë takimit të Komisionit parlamentar të Shëndetësisë

**PASOJAT E MOSFIRMOSJES SË MARRËVESHJES**

Kështu, shqiptarët që kanë punuar në Itali, të cilët nuk kanë 20 vite kontribute nuk përfitojnë pension pa u riatdhesuar në Shqipëri. Në rastin kur një emigrant shqiptar që ka punuar në Itali 19 vjet dhe në Shqipëri 14 vjet; nuk përfiton pension nga Italia se nuk ka plotësuar 20 vjet për t'u futur në kushte pensioni; e po ashtu edhe në Shqipëri nuk përfiton, sepse ka 14 vjet dhe nuk ka plotësuar 15 vite për të marrë të paktën pension të pjesshëm. Pra 33 vite pune me kontribute të emigrantit shqiptar, nuk reflektohen në të ardhurat që mund të ketë. Kështu që në rast të bashkimit të periudhave kontributive; në rast të një marrëveshje bilaterale krijohet tërësisht mundësia për të marrë përfitime nga të dy shtetet.


SCPA PROGRAM

**STRENGTHENING COMMUNITY POLICING IN ALBANIA**

**Call for Proposals**

Call for a contractor to conduct a Police Satisfaction Study in the 12 regions (Qarqet) of Albania:

Type of Contract - Short term consultancy
Languages Required - English and Albanian
Location -12 Regional areas of Albania
Commencement Date - 9 April 2018

With the support of the SCPA project the ASP wants to acquire reliable data on the level of satisfaction of citizens towards the services provided by the police, in order to adjust the strategies, action plans and resources to the areas that concern the most the public.

The terms of reference for this study can be downloaded from the following link : http://www.cp-project.al/web/en/2018/03/call-for-proposals/

**Deadline for receipt of applications: - 30th of March 2018, 17:00 hrs**

The applications shall be submitted by email at info@cp-project.al.



PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

"Permbaruesi gjyqesor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e trete per shitjen e pasurive te paluajtshme :

**1.** Apartament me Nr. pasurie 118/57+2-10, ZK 3292, vol 38, faqe 184, me siperfaqe 94.5 m², te ndodhur ne Selite, Tirane;
**2.** Apartament me Nr. pasurie 118/57+2-11, ZK 3292, vol 38, faqe 185, me siperfaqe 99 m², te ndodhur ne Selite, Tirane,

*per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit Shoqerise "EDIL-AL-IT" Sh.p.k., ne shumat 67'927(gjashtedhjete e shtate mije e nenteqind e njezete e shtate)Euro dhe 309'225(treqind e nente mije e dyqind njezete e pese) Leke.*

Çmimet me të cilat fillon ankandi i trete jane ne vlerat :

**1.** Apartament me nr. pasurie 118/57+2-10, ZK 3292,vol 38, faqe 184, me siperfaqe 94.5 m², te ndodhur ne Selite, Tirane, ne shumen 40'484(dyzete mije e katerqind e tetedhjete e kater)Euro;
**2.** Apartament me nr pasurie 118/57+2-11, ZK 3292,vol 38, faqe 185, me siperfaqe 99 m², te ndodhur ne Selite, Tirane, ne shumen 41'983(dyzete e nje mije e nenteqind e tetedhjete e tre)Euro;
**Ankandi i trete zhvillohet ne date 03.04.2018, ora 16.00 ne zyren e përmbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", Qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0695370060, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com."**


PROJEKTI



## Oficerët e sigurisë, Nikolla: Nisma do të zgjerohet më tej

Nisma "Oficerët e sigurisë në shkolla", ka hyrë në javën e dytë të zbatimit të tij në shkollat e Tiranës. Ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ka inspektuar zbatimin e kësaj nisme në shkollën "Eqerem Çabej" ku takoi Juela Tufën, oficeren e sigurisë e atashuar pranë kësaj shkolle. Ministrja e cilësoi javën e parë të këtij projekti pilot si një javë të mbarë, bazuar nga të dhënat e marra nga 15 gjimnazet e Tiranës, si nga mësuesit, por edhe nga prindërit e nxënësve. "Besoj që duhet ripërmendur edhe njëherë fakti që edhe nxënësit e thonë, që i shohin si miq për të mësuar në një mjedis më të sigurt, mësuesit po ashtu i shohin si miq të mirë për të mundësuar siguri edhe në ato ambiente ku mësuesi nuk është prezent, drejtuesit e shkollës po ashtu, por besoj që të gjithë bashkë do të bëjmë të mundur atë që mbetet misioni i shkollës, mbetet misioni i mësuesit, një mjedis i sigurt për të mirë arsimuar dhe mirë edukuar nxënësit" - deklaroi Nikolla. Kjo e fundit theksoi se suksesi i javës së parë lë vend për besim që ky projekt të marrë shtrirje edhe më të gjerë në shkolla.

Renditja e aplikantëve sipas pikëve, kush fiton në fizioterapi, logopedi e imazheri

# LISTA/ Shpallen emrat e infermierëve fitues, kaluan fazën e parë

## *MSHMS: Ja kur do të zhvillohet testimi me shkrim*

Voltiza Duro

Rreth 3500 kandidatët që kanë aplikuar për një vend pune në spital apo qendër shëndetësore nëpërmjet portalit "Infermierë për Shqipërinë", tashmë mund të verifikojnë nëse janë fitues apo jo. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listën e plotë me emrat e fituesve të fazës së parë në fushën e infermierisë, fizioterapisë, teknikë imazherie, teknikë laboratori, mami dhe logopedi. Deri më tani janë plot 1945 kandidatë që do të testohen për 416 vende të lira pune në profesionet e sipërpërmendura. Respektivisht po kandidojnë 1376 infermierë, 300 mami, 59 fizioterapistë, 98 teknikë imazherie, 107 teknikë laboratori dhe 5 logopedistë. "Pas fazës së parë të shpalljes së listës paraprake të kandidatëve të interesuar, ju dhamë kohë 2354 aplikantëve për të plotësuar dokumentacionin",-u shpreh në një deklaratë për mediat zv/ministrja e Shëndetësisë, Mira Rakacolli. Në listë kandidatët që kanë aplikuar mund të gjejnë pikët që kanë grumbulluar, bazuar në kriteret sipas mesatares, vjetërsisë në punë, diplomave master e gjuhës së huaj. "Kandidatët dhe të gjithë të interesuarit kanë 5 ditë kohë për ankimim për pikët duke filluar që sot (dje) dhe pas pesë ditëve për shqyrtimin e ankesave. Më datë 29 mars do të kemi listën me renditjen përfundimtare të kandidatëve që do të futen në testim",-thuhet në deklaratën e Ministrisë së Shëndetësisë, Sportit e Rinisë.

### TESTIMI ME SHKRIM

Pas kësaj, pritet të zhvillohet testimi me shkrim në katër qarqe, respektivisht në Tiranë, Shkodër, Elbasan dhe Vlorë. Në Tiranë, konkursi do të zhvillohet më datë 31 mars, në orën 14.00 në ambientet e universitetit mjekësor Tiranë. Për kandidatët e qarqeve Vlorë, Fier dhe Gjirokastër, testimi do të kryhet në Vlorë më datë 2 prill në ambientet e universitetit "Ismail Qemali" në orën 14.00. Për kandidatët e qarqeve Shkodër, Dibër, Lezhë, Kukës dhe Durrës, testimi do të zhvillohet më datë 3 prill në ambientet e universitetit "Luigj Gurakuqi" në orën 14.00. Për kandidatët e qarqeve Elbasan, Korçë dhe Berat, testimi do të zhvillohet në ambientet e universitetit "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan në datë 4 prill, në orën 14.00.

### QARKU TIRANE LISTA E KANDIDATEVE INFERMIERE

| Nr | Emër Atësi Mbiemër | Pikët |
|---|---|---|
| 1 | Saimir Ferman Velaj | 27.6 |
| 2 | Jurgen Qerim Lame | 26.9 |
| 3 | Anduel Sali Boduri | 26.8 |
| 4 | Rajmonda Dyle Ruçi | 26.7 |
| 5 | Lizeta Dashamir Makri | 26.6 |
| 6 | Ardi Xhevahir Keçi | 26 |
| 7 | Ilva Maksim Shaholli | 25.9 |
| 8 | Inva Kujtim Basha | 25.9 |
| 9 | Xhoana Nevrus Murtaj | 25 |
| 10 | Aleksander Ajet Terziu | 24.4 |
| 11 | Floreta Luftar Zhupa | 24.4 |
| 12 | Demona Abas Abas | 24.2 |
| 13 | Shqiponja Latif Strataj | 24.1 |
| 14 | Lavderim Astrit Kapushi | 24 |
| 15 | Emanuela Rustem Harremi | 23 |
| 16 | Bilbil Shefki Morina | 22.5 |
| 17 | Genta Dhimiter Meta | 22.5 |
| 18 | Eriola Qemal Suli | 20.3 |
| 19 | Megi Zyhdi Muça | 20 |
| 20 | Adela Fatmir Mali | 19.9 |
| 21 | Leonora Servet Dervishi | 19 |
| 22 | Rrezart Selim Aliaj | 19 |
| 23 | Sami Rustem Hoda | 16.4 |
| 24 | Edilson Edmond Xhiku | 16.3 |
| 25 | Eriseldi Xhafer Telhallari | 16.3 |
| 26 | Pranvera Mete Arifaj | 16.3 |
| 27 | Alida Et\\\'Hem Hamzallari | 16.2 |
| 28 | Jonida Kujtim Lusha | 16 |
| 29 | Florian Adem Kademi | 15.9 |
| 30 | Krishtian Tonin Kolgjokaj | 15.6 |
| 31 | Fjorida Llazar Pjetri | 14.5 |
| 32 | Nife Shyqyri Mehalla | 14.5 |
| 33 | Lesilda Xhezmi Lice | 14.2 |
| 34 | Arjola Arben Zoto | 14 |
| 35 | Xhulia Vladimir Marina | 14 |
| 36 | Eda Kujtim Memushi | 13.9 |
| 37 | Marie Pjetër Prenga | 13.7 |
| 38 | Boreta Bexhet Myteveli | 13.6 |
| 39 | Alma Mynyr Kajtazi | 13.5 |
| 40 | Mimoza Petrit Alla | 13.4 |
| 41 | Gonilda Rolandi Shtrepi | 13.2 |
| 42 | Lindita Syl Bardhoshi | 13 |
| 43 | Ermira Granit Kuqi | 12.9 |
| 44 | Gistina Lumturim Shpata | 12.9 |
| 45 | Emanuela Petrit Radomi | 12.5 |
| 46 | Neritan Feriz Imeraj | 12.5 |
| 47 | Alma Aleksander Marku | 12.4 |
| 48 | Shpendi Subi Mani | 12.4 |
| 49 | Valbona Astrit Shehu | 12.4 |
| 50 | Aurel Hamdi Hallulli | 12.2 |
| 51 | Ajet Besim Muca | 11.9 |
| 52 | Arsilda Defrim Lica | 11.9 |
| 53 | Julia Tonin Ndoj | 11.9 |
| 54 | Fatjona Agron Troka | 11.7 |
| 55 | Donatela Liman Ziri | 11.6 |
| 56 | Jurgen Qerim Lame | 11.6 |
| 57 | Bernarda Nezir Stoli | 11.5 |
| 58 | Erind Shazivar Thartori | 11.5 |
| 59 | Lenada Namik Muho | 11.5 |
| 60 | Marsilda Gezim Hysa(Cakalli) | 11.5 |
| 61 | Miranda Hasim Troka | 11.5 |
| 62 | Sonila Nuri Loca | 11.5 |
| 63 | Valbona Mesut Hoxha | 11.5 |
| 64 | Edisjola Sulejman Abdiaj | 11.3 |
| 65 | Juela Ismet Daci | 11.2 |
| 66 | Evelina Tofik Mikli | 11 |
| 67 | Jonida Muharren Rucaj | 11 |
| 68 | Adelina Banush Preci Kycyku | 10.7 |
| 69 | Elena Llazar Furxhiu | 10.6 |
| 70 | Ermal Mustafa Ismalaja | 10.6 |
| 71 | Diana Selman Vlashi | 10.4 |
| 72 | Erjona Mustafa Ibrahimi | 10.4 |
| 73 | Mariglen Maksim Sanxhaku | 10.4 |
| 74 | Nertila Enver Resulaji 855 | 10.4 |
| 75 | Oriola Vangjel Kule | 10.3 |
| 76 | Shqipe Gzim Leka | 10.3 |
| 77 | Voltisa Sabri Stafa | 10.3 |
| 78 | Armelinda Arben Ferracaku | 10.2 |
| 79 | Suela Ismail Kazdedja | 10.2 |
| 80 | Blerina Shyqiri Ballgjini | 10.1 |
| 81 | Elton Qerim Mema | 10.1 |
| 82 | Marsela Shkelqim Shaqiraj | 10.1 |
| 83 | Miranda Ilias Terpollari | 10.1 |
| 84 | Novela Emin Çera | 10.1 |
| 85 | Redion Medi Halilaj | 10.1 |
| 86 | Blerda Gezim Kulici | 10 |
| 87 | Diana Selman Poda | 10 |
| 88 | Ersilda Lutfi Cupi | 10 |
| 89 | Fitim Mustafa Gjini | 10 |
| 90 | Gresa Reshat Tafili (Cekaj) | 10 |
| 91 | Nertila Minir Loli Hajderlli | 10 |
| 92 | Rinalda Binak Malizi | 10 |
| 93 | Tamara Ilirjan Telhollari | 10 |
| 94 | Besmir Ismail Kasa | 9.9 |
| 95 | Edona Hamdi Doci | 9.9 |
| 96 | Elsa Fadil Xhelili | 9.9 |
| 97 | Eni Nikollaq Çuko | 9.9 |
| 98 | Erid Arian Cuka | 9.9 |
| 99 | Ilirjana Hashim Koldashi | 9.9 |
| 100 | Olga Mihal Jano | 9.9 |
| 101 | Saimir Ferman Velaj | 9.9 |
| 102 | Eglantina Hysen Vervali | 9.8 |
| 103 | Enxhi Lulzim Beqiri | 9.7 |
| 104 | Kleanti Rahmi Çaushi | 9.7 |
| 105 | Rezarta Islam Halilaj | 9.7 |
| 106 | Amarildo Naim Rrushi | 9.6 |
| 107 | Deisilda Medi Gogo | 9.6 |
| 108 | Elis Loni Daka | 9.6 |
| 109 | Entela Mehdi Bezati | 9.6 |
| 110 | Eraldo Kristaq Andoni | 9.6 |
| 111 | Marsida Ilia Yskollari | 9.6 |
| 112 | Marte Nikoll Kolgjokaj | 9.6 |
| 113 | Aishe Rexhep Kryemadhi | 9.5 |
| 114 | Fatjeta Haki Pepkolaj | 9.5 |
| 115 | Jerina Kole Lleshaj | 9.5 |
| 116 | Manushaqe Ruzhdi Vejzi | 9.5 |
| 117 | Sanije Fetah Shehu | 9.5 |
| 118 | Viola Hebib Ademaj | 9.5 |
| 119 | Anxhela Kastriot Selmanaj | 9.4 |
| 120 | Evelina Robert Lani | 9.4 |
| 121 | Morena Belul Onjea | 9.4 |
| 122 | Olta Agim Ajazi | 9.4 |
| 123 | Oriada Xhevdet Lala | 9.4 |
| 124 | Sadik Muhamet Kullafi | 9.4 |
| 125 | Xhensila Urim Mekolli | 9.3 |
| 126 | Albana Ahmet Kuka | 9.3 |
| 127 | Blerta Jonuz Imeri | 9.3 |
| 128 | Blerta Jonuz Imeri | 9.3 |
| 129 | Daniela Zef Markaj | 9.3 |
| 130 | Hamza Bajram Truka | 9.3 |
| 131 | Katerina Gezim Pera | 9.3 |
| 132 | Marjon Jonus Sino | 9.3 |
| 133 | Migena Vizon Hila | 9.3 |
| 134 | Anastelate Sulejman Telushi | 9.2 |
| 135 | Daniela Dashnor Xhaxha | 9.2 |
| 136 | Dorentina Nasi Dedej | 9.2 |
| 137 | Dorjan Esat Agalliu | 9.2 |
| 138 | Fluturrie Elmaz Mollanji | 9.2 |
| 139 | Irena Gani Shabani | 9.2 |
| 140 | Aida Abedin Sokolaj | 9.1 |
| 141 | Fatjon Hidajet Tafa | 9.1 |
| 142 | Jonida Pellumb Vathi | 9.1 |
| 143 | Jorild Perparim Zenelaj | 9.1 |
| 144 | Lavdie Mehmet Ballcaj | 9.1 |
| 145 | Xhorxhina Vladimir Metushi | 9.1 |
| 146 | Anisa Isuf Bajrami Hazma | 9 |
| 147 | Besmira Stak Kola | 9 |
| 148 | Eva Marko Vogli | 9 |
| 149 | Gea Muhamer Përi | 9 |
| 150 | Ilda Myqerem Rrapaj | 9 |
| 151 | Mersida Jemin Lala | 9 |
| 152 | Pietro Niko Cauli | 9 |
| 153 | Sidorela Vesel Aruci | 9 |
| 154 | Violeta Bajram Demhasa | 9 |
| 155 | Xhorxhina Vladimir Metushi | 9 |
| 156 | Irena Hasan Koçi | 8.9 |
| 157 | Klediana Sherif Kallmi (Vesho) | 8.9 |
| 158 | Leonora Fatmir Shira | 8.9 |
| 159 | Rajmonda Dyle Ruçi | 8.9 |
| 160 | Zhosiana Istref Domi | 8.9 |
| 161 | Agila Pajazit Vrenezi Piku | 8.8 |
| 162 | Aleksandra Reit Rama | 8.8 |
| 163 | Anjeza Veis Canaku | 8.8 |
| 164 | Arben Vangjel Dedja | 8.8 |
| 165 | Atika Ali Kadi | 8.8 |
| 166 | Ermelinda Mehmet Kastrati | 8.8 |
| 167 | Fatime Agim Gjura | 8.8 |
| 168 | Najada Kujtim Shkjau | 8.8 |
| 169 | Romina Ndue (Mercina)Kasa | 8.8 |
| 170 | Rudina Kostandin Kola | 8.8 |
| 171 | Vjollca Bajram Seitaj | 8.8 |
| 172 | Denisa Zilfi Pirra | 8.7 |
| 173 | Ediola Fatmir Vreto | 8.7 |
| 174 | Elona Dod Nikolli | 8.7 |
| 175 | Fatjon Sherif Subashi | 8.7 |
| 176 | Flamur Hazis Marku | 8.7 |
| 177 | Jonida Kujtim Lusha | 8.7 |
| 178 | Sidorela Nuri Shehi | 8.7 |
| 179 | Marcela Agim Vogli | 8.68 |
| 180 | Anduel Sali Boduri | 8.6 |
| 181 | Bukuroshe Hajri Meta | 8.6 |
| 182 | Dallendyshe Bexhet Shehu | 8.6 |
| 183 | Irena Eduart Shtylla | 8.6 |
| 184 | Manjola Zek Ndoci | 8.6 |
| 185 | Matilda Hamet Pasha | 8.6 |
| 186 | Mine Selman Loshe | 8.6 |
| 187 | Shqiponja Muharrrem Ramadani (Haxhaj) | 8.6 |
| 188 | Sofie Shaban Kashari | 8.6 |
| 189 | Valbona Nuhi Shehu | 8.6 |
| 190 | Xhulia Fatbardh Gurguri | 8.6 |
| 191 | Alida Et'Hem Hamzallari | 8.5 |
| 192 | Erald Qamil Velaj | 8.5 |
| 193 | Fjorida Llazar Pjetri | 8.5 |
| 194 | Jonila Bektash Drizaj (Shani) | 8.5 |
| 195 | Jorid Gramos Agalliu | 8.5 |
| 196 | Orgela Bashkim Hysenbelliu | 8.5 |
| 197 | Alma Mynyr Kajtazi | 8.4 |
| 198 | Ardi Xhevahir Keçi | 8.4 |
| 199 | Arsilda Defrim Lica | 8.4 |
| 200 | Elena Llazar Furxhiu | 8.4 |
| 201 | Eriseldi Xhafer Telhallari | 8.4 |
| 202 | Ermal Mustafa Ismalaja | 8.4 |
| 203 | Fatjona Agron Troka | 8.4 |
| 204 | Irena Ahmet Bami | 8.4 |
| 205 | Jurgen Qerim Lame | 8.4 |
| 206 | Megi Zyhdi Muça | 8.4 |
| 207 | Merita Hamit Hima | 8.4 |
| 208 | Ediola Fatmir Vreto | 8.3 |
| 209 | Eldisa Bujar Saliu (Veliu) | 8.3 |
| 210 | Elona Dod Nikolli | 8.3 |
| 211 | Marte Nikoll Kolgjokaj | 8.3 |
| 212 | Miranda Ilias Terpollari | 8.3 |
| 213 | Nertila Enver Resulaji | 8.3 |
| 214 | Anita Kristo Koci | 8.2 |
| 215 | Arsilda Defrim Lica | 8.2 |
| 216 | Boreta Bexhet Myteveli | 8.2 |
| 217 | Edisjola Sulejman Abdiaj | 8.2 |
| 218 | Elsa Petrit Koleci | 8.2 |
| 219 | Fjorida Llazar Pjetri | 8.2 |
| 220 | Gea Muhamer Përi | 8.2 |
| 221 | Klediana Sherif Kallmi (Vesho) | 8.2 |
| 222 | Krishtian Tonin Kolgjokaj | 8.2 |
| 223 | Maslime Idriz Kadiu | 8.2 |
| 224 | Morena Belul Onjea | 8.2 |
| 225 | Pranvera Mete Arifaj | 8.2 |
| 226 | Sami Rustem Hoda | 8.2 |
| 227 | Shpendi Subi Mani | 8.2 |
| 228 | Xhensila Urim Mekolli | 8.2 |
| 229 | Arjola Lazim Bardhi | 8.1 |
| 230 | Donatela Liman Ziri | 8.1 |
| 231 | Evelina Tofik Mikli | 8.1 |
| 232 | Juela Ismet Daci | 8.1 |
| 233 | Jurgen Qerim Lame | 8.1 |
| 234 | Majlinda Mark Geci (Suli) | 8.1 |
| 235 | Marte Nikoll Kolgjokaj | 8.1 |
| 236 | Mexhide Qazim Morina | 8.1 |
| 237 | Nertila Enver Resulaj | 8.1 |
| 238 | Olga Mihal Jano | 8.1 |
| 239 | Selvije Ahmet Sinani | 8.1 |
| 240 | Shqipe Gzim Leka | 8.1 |
| 241 | Voltisa Sabri Stafa | 8.1 |
| 242 | Aleksandra Reit Rama | 8 |
| 243 | Anduel Sali Boduri | 8 |
| 244 | Anisa Isuf Bajrami Hazma | 8 |
| 245 | Anxhela Kastriot Selmanaj | 8 |
| 246 | Blerina Shyqiri Ballgjini | 8 |
| 247 | Diamanta Rrahman Bara | 8 |
| 248 | Evelina Robert Lani | 8 |
| 249 | Fatime Agim Gjura | 8 |
| 250 | Jonida Kujtim Lusha | 8 |
| 251 | Jonila Bektash Drizaj (Shani ) | 8 |
| 252 | Lavdie Mehmet Ballcaj | 8 |
| 253 | Rinalda Binak Malizi | 8 |
| 254 | Shqiponja Muharrrem Ramadani (Haxhaj) | 8 |
| 255 | Suela Ismail Kazdedja | 8 |
| 256 | Suzana Zenel Canameti | 8 |
| 257 | Violeta Bajram Demhasaj | 8 |
| 258 | Xhensila Urim Mekolli | 8 |
| 259 | Alida Et'Hem Hamzallari | 7.9 |
| 260 | Ardi Xhevahir Keçi | 7.9 |
| 261 | Boreta Bexhet Myteveli | 7.9 |
| 262 | Dallëndyshe Bexhet Shehu | 7.9 |
| 263 | Donatela Liman Ziri | 7.9 |
| 264 | Edisjola Sulejman Abdiaj | 7.9 |
| 265 | Evelina Tofik Mikli | 7.9 |
| 266 | Juela Ismet Daci | 7.9 |
| 267 | Jurgen Qerim Lame | 7.9 |
| 268 | Majlinda Mark Geci (Suli) | 7.9 |
| 269 | Marsida Ilia Yskollari | 7.9 |
| 270 | Mirushe Ymer Begteshi | 7.9 |
| 271 | Nertila Enver Resula | 7.9 |
| 272 | Olga Mihal Jano | 7.9 |
| 273 | Sami Rustem Hoda | 7.9 |
| 274 | Shqiponja Latif Strataj | 7.9 |
| 275 | Shqiponja Muharrrem Ramadani (Haxhaj) | 7.9 |
| 276 | Voltisa Sabri Stafa | 7.9 |
| 277 | Dorjan Esat Agalliu | 7.8 |
| 278 | Ermelinda Mehmet Kastrati | 7.8 |
| 279 | Flamur Hazis Marku | 7.8 |
| 280 | Jonida Kujtim Lusha | 7.8 |
| 281 | Klodeta Dashnor Sharku | 7.8 |
| 282 | Rajmonda Dyle Ruçi | 7.8 |
| 283 | Rudina Kostandin Kola | 7.8 |
| 284 | Sadik Muhamet Kullafi | 7.8 |
| 285 | Saimir Ferman Velaj | 7.8 |
| 286 | Violeta Bajram Demhasaj | 7.8 |
| 287 | Andi Xhelal Kapllani | 7.7 |
| 288 | Aurel Hamdi Hallulli | 7.7 |
| 289 | Erid Arian Cuka | 7.7 |
| 290 | Najada Kujtim Shkjau | 7.7 |
| 291 | Ganian Shpetim Hyseni | 7.6 |
| 292 | Ilirjana Hashim Koldashi | 7.6 |
| 293 | Mariglen Petrit Rama | 7.6 |
| 294 | Suela Dashnor Dade | 7.6 |
| 295 | Blerina Shyqyri Ballgjini | 7.5 |
| 296 | Elona Dod Nikolli | 7.5 |
| 297 | Enis Fatmir Mema | 7.5 |
| 298 | Ferdinant Petrit Bardhi | 7.5 |
| 299 | Fjoralba Ramadan Geraj | 7.5 |
| 300 | Fluturrie Elmaz Mollanji | 7.5 |
| 301 | Imer Fiqret Daka | 7.5 |
| 302 | Lizeta Dashamir Makri | 7.5 |
| 303 | Mihane Gëzim Debrova Zoto | 7.5 |
| 304 | Shqiponja Muharrrem Ramadani (Haxhaj) | 7.5 |
| 305 | Violeta Bajram Demhasaj | 7.5 |
| 306 | Ardi Xhevahir Keçi | 7.4 |
| 307 | Denisa Venedik Hoxha | 7.4 |
| 308 | Emanuela Rustem Harremi | 7.4 |
| 309 | Flamur Hazis Marku | 7.4 |
| 310 | Imer Fiqret Daka | 7.4 |
| 311 | Jetnor Sulejman Hajdarmataj | 7.4 |
| 312 | Kreshnik Refai Tivari | 7.4 |
| 313 | Majlinda Besim Beu | 7.4 |
| 314 | Mariglen Petrit Rama | 7.4 |
| 315 | Sadik Muhamet Kullafi | 7.4 |
| 316 | Sami Rustem Hoda | 7.4 |
| 317 | Sami Rustem Hoda | 7.4 |

| | | |
|---|---|---|
| 318 | Trendafile Yzir Hajdini | 7.4 |
| 319 | Aferdita Pal Nikolli | 7.3 |
| 320 | Andi Xhelal Kapllani | 7.3 |
| 321 | Anjeza Veis Canaku | 7.3 |
| 322 | Esma Adnand Aga | 7.3 |
| 323 | Hamide Fiqiri Armadhi | 7.3 |
| 324 | Natasha Ibrahim Berdhoshi (gjypi) | 7.3 |
| 325 | Rajmonda Bajram Xhaferri | 7.3 |
| 326 | Sadik Muhamet Kullafi | 7.3 |
| 327 | Anisa Robert Balle | 7.2 |
| 328 | Anxhela Kastriot Selmanaj | 7.2 |
| 329 | Blerta Jonuz Imeri | 7.2 |
| 330 | Dorina Arqile Proko (Leka) | 7.2 |
| 331 | Entela Mehdi Bezati | 7.2 |
| 332 | Eraldo Kristaq Andoni | 7.2 |
| 333 | Evelina Robert Lani | 7.2 |
| 334 | Florina Isuf Zaimi | 7.2 |
| 335 | Hyjnela Fatmir Shima | 7.2 |
| 336 | Irena Shpetim Qefalia | 7.2 |
| 337 | Jerina Kole Lleshaj | 7.2 |
| 338 | Kristiana Miltjadh Koco | 7.2 |
| 339 | Lavdie Mehmet Ballcaj | 7.2 |
| 340 | Migena Vizon Hila | 7.2 |
| 341 | Migena Rebani Agalliu | 7.2 |
| 342 | Mimoza Laske Merko | 7.2 |
| 343 | Sadik Muhamet Kullafi | 7.2 |
| 344 | Xhensila Urim Mekolli | 7.2 |
| 345 | Hamza Bajram Truka | 7.13 |
| 346 | Aida Abedin Sokolaj | 7.1 |
| 347 | Anilda Albert Vojkollari | 7.1 |
| 348 | Besmira Stak Kola | 7.1 |
| 349 | Blerta Jonuz Imeri | 7.1 |
| 350 | Daniela Zef Markaj | 7.1 |
| 351 | Dorjan Esat Agalliu | 7.1 |
| 352 | Ernela Vladimir Liço | 7.1 |
| 353 | Irena Gani Shabani | 7.1 |
| 354 | Jonida Pellumb Vathi | 7.1 |
| 355 | Jora Gëzim Jolla | 7.1 |
| 356 | Mersida Jemin Lala | 7.1 |
| 357 | Milika Sotir Simoni | 7.1 |
| 358 | Mirushe Ymer Begteshi | 7.1 |
| 359 | Violeta Bajram Demhasaj | 7.1 |
| 360 | Xhorxhina Vladimir Metushi | 7.1 |
| 361 | Adela Fatmir Mali | 7 |
| 362 | Demona Abas Abas | 7 |
| 363 | Edisona Mentor Teta | 7 |
| 364 | Gea Muhamer Përi | 7 |
| 365 | Inva Kujtim Basha | 7 |
| 366 | Leonora Servet Dervishi | 7 |
| 367 | Maslime Idriz Kadiu | 7 |
| 368 | Megi Zyhdi Muça | 7 |
| 369 | Pranvera Mete Arifaj | 7 |
| 370 | Xhoana Nevrus Murtaj | 7 |
| 371 | Alida Ethem Hamzallari | 6.9 |
| 372 | Edisjola Sulejman Abdiaj | 6.9 |
| 373 | Eriseldi Xhafer Telhallari | 6.9 |
| 374 | Fjorida Llazar Pjetri | 6.9 |
| 375 | Jonida Kujtim Lusha | 6.9 |
| 376 | Klediana Sherif Kallmi (Vesho) | 6.9 |
| 377 | Krishtian Tonin Kolgjokaj | 6.9 |
| 378 | Marinela Bedri Alushaj | 6.9 |
| 379 | Migena Gezim Reka | 6.9 |
| 380 | Nife Shyqyri Mehalla | 6.9 |
| 381 | Sami Rustem Hoda | 6.9 |
| 382 | Aleksander Ajet Terziu | 6.8 |
| 383 | Alma Mynyr Kajtazi | 6.8 |
| 384 | Arjola Arben Zoto | 6.8 |
| 385 | Boreta Bexhet Myteveli | 6.8 |
| 386 | Eda Kujtim Memushi | 6.8 |
| 387 | Ersilda Lutfi Çupi | 6.8 |
| 388 | Gistina Lumturim Shpata | 6.8 |
| 389 | Mimoza Petrit Alla | 6.8 |
| 390 | Emanuela Petrit Radomi | 6.7 |
| 391 | Ermira Granit Kuqi | 6.7 |
| 392 | Irena Ahmet Bami | 6.7 |
| 393 | Manada Nazmi Cani | 6.7 |
| 394 | Alma Aleksander Marku | 6.6 |
| 395 | Amarildo Naim Rrushi | 6.6 |
| 396 | Arba Vehbi Dada | 6.6 |
| 397 | Dallandyshe Cane Marko | 6.6 |
| 398 | Elsa Petrit Koleci | 6.6 |
| 399 | Eralda Gezim Pema | 6.6 |
| 400 | Fatjona Agron Troka | 6.6 |
| 401 | Gonilda Rolandi Shtrepi | 6.6 |
| 402 | Jurgen Qerim Lame | 6.6 |
| 403 | Marinela Kadri Memishaj | 6.6 |
| 404 | Marsilda Gezim Hysa(Cakalli) | 6.6 |
| 405 | Valbona Astrit Shehu | 6.6 |
| Tiranë | | |
| Shkodër | Sose Fusha | |
| Korçë | THEMI NAQO | |
| Shkodër | Giuseppe Lanza | 2,823,513 |
| Shkodër | Agim Kraja | 8,800,560 |
| Shkodër | Agim Kraja | 9,533,940 |
| Shkodër | Trashg. Smaja | |
| Vlorë | Irma Zaho | EZAURUAR |
| Vlorë | Kisha Autoqefale Shqiptare | EZAURUAR |
| Fier | Lili Bare | |
| Fier | Seit Kanaj | |
| Dibër | ILIR SALLAKU | |
| Dibër | ILIRE , GANIMETE, HAMZA SALLAKU , RIZVANI , DEDJA | |
| Shkodër | Berhan Ademi | 4,272,522 |
| Shkodër | Berhan Ademi | 14,638,920 |
| Tiranë | ISLAM ALIMEHEMTI | |
| Tiranë | FOTINI ZALLOTI | 11,953,967 |
| Tiranë | QERIME BLAKÇORI | 20,693,421 |
| Vlorë | Jori Bekari | EZAURUAR |
| Dibër | Kol Gjok Gjeçi | |
| Elbasan | Zenel Dermyshi | 1,446,651 |
| Fier | Yzedin Sulaj | 1,219,760 |
| Fier | Gani Avdullai | 1,540,424 |
| Fier | Fecor Beqiraj | |
| Durrës | Rexhep Selimi | |
| Durrës | Bejtulla Tepshi | |
| Durrës | Arjana Vasil Hametlli | - |
| Durrës | Aqif Çelkupa | |
| Durrës | Vasil Gjergo | |
| Durrës | Vasil Gjergo | |
| Durrës | Ermira Kapuli | |
| Durrës | Xhemal Turku | |
| Durrës | Gjergj Qeraxhija | |
| Durrës | Rita Çuni | |
| Durrës | Hamza Muça | |
| Durrës | Hamdi Dervishi | |
| Elbasan | Selaudin Vyshka | |
| Elbasan | Ibrahim Vyshka, Kasen Vyshka | 532,800 |
| Fier | vero Lamaj | 702,655 |
| Gjirokastër | Novruz Roci | |
| Gjirokastër | Qazim Jace | 674,152 |
| Korçë | | |
| Korçë | Hekuran Laçi | EZAURUAR |
| Korçë | Sotir Robo | 39,600 |
| Korçë | Gurali Ibrahimi | 131,400 |
| Korçë | Lytfi Mersinllari | EZAURUAR |
| Korçë | Hamit Riza | |
| Korçë | | 568,000 |
| Korçë | Nisret Kadiu | |
| Korçë | Arif Fazo | |
| Korçë | Bajame Hamolli | 438,811 |
| Korçë | Lirie Pambuku, Myfit Pambuku | EZAURUAR |
| Korçë | Gani Isallari | 960,000 |
| Korçë | | 185,399 |
| Korçë | Mehmet Topi | 188,076 |
| Korçë | YLBER LAMCE | 607,354 |
| Lezhë | Mustafa Lama | 29,874,507 |
| Lezhë | Mark Bibe Nikolli(Zuku) | |
| Shkodër | Marije Biga | |
| Tiranë | ISUF DOBJANI | 9,952,325 |
| Tiranë | ENVER KAPIDANI | |
| Tiranë | Abaz Topi | 1,758,115 |
| Tiranë | IBRAHIM XHAMETA | - |
| Tiranë | IBRAHIM XHAMETA | |
| Lezhë | Preng Marku | |
| Korçë | Ferit Tahirllari | 474,300 |
| Kukës | Fatmir Metalija | |
| Gjirokastër | Ollga Tite | |
| Gjirokastër | Ana Barjami | |
| Kukës | Musa Aga | |
| Kukës | Imer Beg Hoxha | |

| | | |
|---|---|---|
| Korçë | Bashkim Maliqi | 358,554 |
| Shkodër | Feride Podgorica | 3,715,792 |
| Shkodër | Adnan Kallogjeri | 9,582,832 |
| Tiranë | AGIM KOKONOZI | |
| Tiranë | ABDULLA KARAJ | 7,299,621 |
| Tiranë | AISHE MEÇANI (SAMI) | - |
| Tiranë | XHELADIN CAUSHI | 8,036,280 |
| Tiranë | SANIE JARANI | 3,803,839 |
| Shkodër | Ndoc Thaci | 1,829,865 |
| Tiranë | Shuaip Llanaj | 753,401 |
| Tiranë | BEATRICE MANUSHI | 11,049,885 |
| Korçë | | |
| Korçë | | |
| Tiranë | SHAQIR PREZA | 20,961,297 |
| Tiranë | | 11,886,998 |
| Tiranë | SANIJE LUGA | 42,391,377 |
| Tiranë | THACI | |
| Tiranë | | |
| Durrës | Zija Xhixhabesi | |
| Durrës | | |
| Durrës | Agron Dobi | |
| Durrës | Ramazan Limanaqi | 2,166,232 |
| Elbasan | XHEZARE SENI | |
| Elbasan | Pasho Hida | 3,793,238 |
| Elbasan | ARIF CARCIU | |
| Elbasan | | |
| Elbasan | HAJRIJE CANI | |
| Elbasan | SHEFQET XHAFERRI | |
| Elbasan | Qamil Guri | 8,877,792 |
| Elbasan | XHEVIT ZANI | |
| Elbasan | VELI ZANI | 997,541 |
| Fier | Halit Kajolli | |
| Korçë | Sazan Berberi | |
| Kukës | Lek Nika | |
| Shkodër | Llesh Brunga | |
| Shkodër | Trashg. Bushati | |
| Shkodër | Esher Duli | |
| Shkodër | Xhahid Bushati | 2,272,437 |
| Shkodër | Fiqerete Pipa | |
| Shkodër | Fiqerete Pipa | |
| Shkodër | Fiqerete Pipa | |
| Shkodër | Eqerem Lohja | |
| Shkodër | Vaide Koka | |
| Shkodër | Harun Berberi | |
| Shkodër | Nikoll Thani | 6,553,470 |
| Shkodër | Ixhlal Sykja | |
| Tiranë | IBRAHIM XHAMETA | EZAURUAR |
| Tiranë | IBRAHIM XHAMETA | EZAURUAR |
| Tiranë | IBRAHIM XHAMETA | EZAURUAR |
| Vlorë | Andon Trifoni | 2,664,300 |
| Vlorë | Mimoza Derolli | |
| Elbasan | SHAHIN BITROSHI | |
| Elbasan | NEZIR KARRIQI | 3,303,749 |
| Korçë | Hajdar Belli | 698,240 |
| Korçë | | 114,728 |
| Korçë | | 206,976 |
| Shkodër | Trash. Ejlli | 69,500 |
| Tiranë | MUHARREM HUQI | EZAURUAR |
| Tiranë | ALI TIRANA | 63,308,520 |
| Tiranë | | 9,610,052 |
| Tiranë | ATLIJE HEMA | |
| Tiranë | HAXHIRE BRAHJA (SHEHU) | 15,134,994 |
| Durrës | Hamit Deda | 6,647,600 |
| Durrës | Muhamet Sefa | 210,705 |
| Durrës | Vjera Kilica | 425,258 |
| Durrës | Kristo Dako | - |
| Elbasan | REFIK SINA | 1,962,006 |
| Fier | Zonje Harunaj | |
| Fier | Idai Sulaj | EZAURUAR |
| Fier | Sabri Maraj | - |
| Korçë | | 4,157,519 |
| Korçë | Viktor Cani | |
| Korçë | Halim Ombashi | 450,000 |
| Fier | Gjolek Shehaj | |
| Shkodër | Jak Gjonaj | 1,123,452 |

| | | |
|---|---|---|
| Shkodër | Mynyr Avdia | 2,701,283 |
| Shkodër | Abdullah Miloti | - |
| Shkodër | Ibrahim Miloti | 1,919,011 |
| Shkodër | Angje Kadija | EZAURUAR |
| Tiranë | IBRAHIM XHAMETA | EZAURUAR |
| Tiranë | ERVEHE GREPSA | 50,210,008 |
| Vlorë | Kalem Tasimi | |
| Durrës | | |
| Korçë | Alma Bullaci | 54,675 |
| Tiranë | ALI NEVIRI | 14,351,457 |
| Tiranë | ALI NEVIRI | 30,939,678 |
| Vlorë | Faik Bataj | |
| Vlorë | Pajtim Çela | |
| Vlorë | Llazar Hoxharo | 6,899,000 |
| Lezhë | Llesh Bib Marku | |
| Lezhë | Zef Preng Kiku | |
| Shkodër | Pjeter Pashko Coba | |
| Shkodër | Enrik Kole Coba | |
| Vlorë | Spiro Bejler | 554,676 |
| Vlorë | Gjolek Brahimi | |
| Dibër | Qamil Gasa | |
| Shkodër | Muhamet Bajraktari | |
| Shkodër | Sabri Dibra | |
| Shkodër | Shyqyri Tevia | |
| Shkodër | Vehid Ramadani | |
| Shkodër | Bashkim Teli | EZAURUAR |
| Tiranë | | EZAURUAR |
| Tiranë | KUJTIM, AVENIR KIKA | EZAURUAR |
| Tiranë | ALDO DELHYSA | 14,905,004 |
| Tiranë | VANGJEL HAXHINASTO | 5,907,942 |
| Tiranë | ARSINAI KERKUSI (LASKU) | 20,827,359 |
| Tiranë | MUHARREM PEZA (HAXHOLLI) | |
| Tiranë | GANI LAMI | EZAURUAR |
| Tiranë | KAMBER HOXHA | EZAURUAR |
| Tiranë | AVENIR KIKA | |
| Tiranë | DHIMITER BERATI | 75,166,006 |
| Tiranë | | |
| Tiranë | | |
| Tiranë | MIHAL KOJA | |
| Tiranë | ALBERT HANXHARI | |
| Tiranë | AVNI ZAJMI | |
| Fier | Isuf Klosi | |
| Fier | Kodhel Isufaj | |
| Korçë | Hasim Pulaha | |
| Korçë | Edmond Grabova | |
| Korçë | | |
| Korçë | Dhimitraq Misha | |
| Tiranë | PERPARIM FARKA | |
| Tiranë | | EZAURUAR |
| Fier | Altin Vrioni | |
| Kukës | Qazim Meshi | |
| Durrës | Xhevahire Marku | |
| Tiranë | SAIMIR DISHA | 5,089,644 |
| Tiranë | VANGJEL KOJA | 8,371,125 |
| Tiranë | VANGJEL KOJA | 38,908,989 |
| Durrës | Fiqirete Gorani | |
| Durrës | Bedri Kokomani | |
| Durrës | Bedri Kokomani | EZAURUAR |
| Durrës | Bedri Kokomani | EZAURUAR |
| Durrës | | |
| Durrës | Lluka Rrufa | |
| Durrës | Lluka Rrufa | |
| Durrës | Xhevdet Mitraku | |
| Durrës | Ali Bardhi | |
| Durrës | Nazmi Hunda | |
| Durrës | Preng Coku | |
| Durrës | Preng Coku | |
| Durrës | Enver Lazimi | 2,290,944 |
| Durrës | Behixhe Karaboja | EZAURUAR |
| Durrës | Vangjel Anastasiadhi | |
| Durrës | Shpati Dragoti | |
| Elbasan | PETRIT KARADAKU | 7,211,660 |
| Elbasan | | 10,185,672 |
| Fier | Bardhyl Zazo | 6,547,168 |
| Fier | Barjam Hysaj | 5,084,554 |
| Fier | Bedri Strumi | |

| | | |
|---|---|---|
| Shkodër | Trash Vokrri | 1,350,000 |
| Shkodër | Trash Lisi (Kodheli) | |
| Shkodër | Ndue dhe Zef Ujka | 460,000 |
| Shkodër | Qemal Osmanagaj | 1,650,105 |
| Shkodër | Ruzhdi Duli | |
| Shkodër | Abdyl Boksi | 7,651,389 |
| Shkodër | Zef Bushati | - |
| Tiranë | BEXHET KOÇI | 3,368,541 |
| Tiranë | JONUZ SHIJAKU | 4,553,892 |
| Tiranë | SEFER KALLUSHI (KALOSHI) | 3,013,605 |
| Tiranë | IKBAL STERMASI | 421,905 |
| Tiranë | IKBAL STERMASI | 2,343,915 |
| Tiranë | HAMID ALIMEHMETI | 19,220,103 |
| Tiranë | HAMID ALIMEHMETI | 1,988,979 |
| Tiranë | HAMID ALIMEHMETI | 803,628 |
| Tiranë | OSMAN MENI | |
| Tiranë | GANI QAZIM HAJDARI | 7,500,528 |
| Tiranë | GANI QAZIM HAJDARI | 3,013,605 |
| Tiranë | SHABAN TUFINA | 4,520,408 |
| Tiranë | SHABAN TUFINA | 4,393,166 |
| Tiranë | SHABAN TUFINA | 7,098,714 |
| Vlorë | Agllaia Bollano | |
| Vlorë | Haxhi Velaj | |
| Vlorë | Xhemal Mecaj | |
| Fier | Rustem Vrioni | |
| Vlorë | Shpresim Kasaj | |
| Korçë | Myrvete Spaho | |
| Kukës | Rexhep Metalia | |
| Lezhë | Dila ;Angjelina Ndoj | |
| Lezhë | Gjon Nikolle Gjuraj | |
| Tiranë | JORGJI HANXHARI | 14,291,854 |
| Tiranë | BAJRAM MALOKU | 97,480,351 |
| Tiranë | LEON LEZHA | 52,972,479 |
| Durrës | Vasil Gjergo | 4,405,650 |
| Durrës | Mustafa Rexha | |
| Durrës | Ahmet Godenca | |
| Durrës | Idriz Keja | |
| Durrës | Filip Gjonçi | 1,163,370 |
| Elbasan | ISUF BAKALLI | 4,619,108 |
| Elbasan | PELLUMB BELULI | 382,920 |
| Elbasan | ENVER DELIMETA | |
| Tiranë | XHEJE VERVALI | EZAURUAR |
| Tiranë | QAZIM TOSKA | 4,021,488 |
| Tiranë | BEDRI MARA | 2,109,524 |
| Tiranë | | 1,674,225 |
| Tiranë | IBRAHIM LULI | EZAURUAR |
| Tiranë | IBRAHIM LULI | 978,432 |
| Tiranë | HATIXHE MUMAJESI | |
| Tiranë | PAVLI HOBDARI | 2,558,216 |
| Tiranë | ADEM KADIU | 1,660,831 |
| Tiranë | HALIL MUÇO | 1,928,707 |
| Tiranë | LUIGJINA, ROZMARI PRIFTI, KODHELI | 18,751,320 |
| Tiranë | OSMAN ALLA | 2,966,057 |
| Tiranë | OSMAN ALLA | 3,281,481 |
| Korçë | Aleksandër Karamitro | |
| Durrës | Idhomen Kosturi | |
| Durrës | Arap Toska | |
| Durrës | Francesk Brahja | |
| Gjirokastër | Skender Ormeni | 447,437 |
| Elbasan | BELUL DOSKU | |
| Elbasan | HASAN ZENELI | 487,891 |
| Elbasan | HEKURAN RADICI | 3,457,238 |
| Gjirokastër | Jorgo Proko | 3,130,635 |
| Gjirokastër | Xhafer Ducellari | 1,690,543 |
| Gjirokastër | Ardian Adhami | |
| Korçë | Muhamer Hoxhallari | |
| Korçë | Asime Ymeti | 159,930 |
| Korçë | Nuri Sulejmani | 697,140 |
| Korçë | Muhamet Xhuli | |
| Korçë | Liri Sade | 568,000 |
| Korçë | Pellumb Berberi | 124,272 |
| Korçë | Teki Kocibelli | 734,000 |
| Kukës | Shkurte Dauti | |
| Kukës | Uke Man Mekshiqi | 2,059,200 |
| Shkodër | Refik Bulaj | - |
| Shkodër | Ali Frexha | 7,974,807 |

*(Vijon)*

Opinioni i Ditës

# "Titaniku" i Austrisë në brigjet shqiptare

Nga Florian Doschek

*(Vijon nga faqja e parë)*

... u la në harresë dhe nuk u xhirua asnjë Hollywood-Blockbuster. Shumë pak nga vizitorët e sotëm, që vizitojnë Kepin piktoresk të Rodonit, e dinë se atje, në det të hapur ka ndodhur një nga tragjeditë detare më të mëdha të historisë. 100 vjet pas mbytjes së "Linz" para brigjeve shqiptare, 100 vjet pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, është koha të kujtojmë këtë fatkeqësi të Austrisë së vjetër, këtë fatkeqësi mbarë europiane, por mbi të gjitha këtë fatkeqësi njerëzore.

**SHËRBIMI PËR LLOYD-IN AUSTRIAK**

Para shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, Trieste ishte porti detar civil më i rëndësishëm i Austrisë së vjetër dhe shërbente si një portë drejt botës. Shoqëria "Lloyd-i austriak" drejtonte nga Trieste një rrjet detar të dendur dhe lidhte Europën Qendrore me porte të vendosura në lindje të Mesdheut deri në Lindjen e Largët (Kine, Honkong, Japoni, Singapor...). Lloyd kishte një emër të shkëlqyer, ofronte një shërbim të një cilësie të lartë dhe u bë një nga shoqëritë më të mëdha botërore të lundrimit detar.

Në shërbim të kësaj shoqërie të nderuar ishte edhe "Linz". Për herë të parë "Linz" la dokun në prill të 1909, ishte 102 metra e gjatë dhe 14 metra e gjerë dhe lundroi fillimisht gjatë rrugës detare ndërmjet Triestes e Kostandinopojës. "Linz" duhej të kish qenë edhe mysafir i rregullt në disa nga portet shqiptare, si të Durrësit e të Vlorës.

Europës nuk i mbeti të gëzonte shumë vite paqeje dhe me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore pushoi praktikisht së ekzistuari edhe lundrimi detar civil. Megjithatë fati i "Linz" deri në fundin tragjik mbeti i lidhur me Shqipërinë. Duke filluar nga viti 1917 "Linz" duhej të transportonte vetëm ushtarë dhe materiale luftarake në drejtim të Shqipërisë.

**NISJA DREJT NJË UDHËTIMI FATKEQ**

Në bazë të dokumenteve zyrtare dhe thënieve të dëshmitarëve okularë mund të rindërtojmë ngjarjen e lundrimit të fundit të Linz-it. Më 18 mars 1918 u bënë përgatitjet për lundrim në gjirin e Kotorit (atëherë ishte bazë e rëndësishme e flotës detare-ushtarake e Austro-Hungarisë). Anija do të lundronte përsëri drejt Shqipërisë dhe sipas listës së fundit të pasagjerëve, në bord ishin zyrtarisht 995 persona. Faktikisht, siç ishte e zakonshme në ato ditë lufte, në bord ishin shumë më tepër persona. Ushtarë të panumërt kishin hipur në anije ilegalisht. Ata ktheheshin nga leja dhe donin të arrinin sa më shpejt në frontin e luftës. Pra, më 18 mars në bord kishte një larmi pasagjerësh. Krahas ekuipazhit ishte midis të tjerëve edhe kompania e këmbësorisë së regjimentit të Honwed-it, personel ushtarak për të zëvendësuar trupat e stacionuara në Shqipëri dhe të afërm të marinës së luftës. Personat vinin nga të gjitha pjesët e mundshme të monarkisë së vjetër austriake, plus kësaj ishin me qindra robër lufte italianë, robër lufte rusë si dhe mjaft gra. Të gjitha dhomat e hapësirat ishin të mbimbushura, po ashtu në anijen "Linz" gjendeshin më shumë se 400 lopë.

Rreth orës 18:00 anija u nis, la portin e Zelenikes në gjirin e Kotorit dhe u drejtua drejt Durrësit. Atmosfera ishte e gëzueshme dhe e hareshme, sepse për shumë ushtarë ishte udhëtimi i parë në det të hapur me këtë avullore të madhe. Për ta mbrojtur, Linz-in e shoqëronte torpediniera 98M. Pak më vonë nga nisja iu shtua një torpediniere e dytë si dhe kryqëzori




"Balaton", sepse në zonën ndërmjet Kotorit dhe Durrësit kishte një aktivitet të dendur të nëndetëseve armike. Atë natë ishte "det i vdekur", sipas dy dëshmitarëve të kohës, me ulje e ngritje të valëve deri nën sipërfaqen e qetë në dukje të detit. Në fillim lundrimi ishte i qetë dhe rreth orës 23:00 anija arriti grykëderdhjen e Bunës e mori kursin drejt Kepit të Rodonit.

**SULMI MBI LINZIN**

Rreth orës 00:30 sapo kish hyrë 19 marsi, "Linz" ndodhej pak milje deti në veri të Kepit të Rodonit. Marinari Albin Biskup i torpedinieres 98M raportoi se "Linz" ishte 200 m larg tyre në një udhëtim të qetë. Papritmas marinarët e torpedinieres vërejtën një shtëllungë uji të bardhë vezulluese, që iu drejtua me shpejtësi Linz-it, "Manteli i argjendë i vdekjes" e përshkroi atë Biskup. Pak çaste më vonë Linz-i u godit nga silura dhe një shpërthim i tmerrshëm prishi qetësinë e natës. Goditja ishte me pasoja të mëdha dhe vulosi fatin e anijes. Shumë shpejt anija humbi ekuilibrin dhe u anua fort. Numri i madh i pasagjerëve që synonin të gjithë drejt kuvertës, çoi menjëherë në një kaos të vërtetë. Varkat e mbimbushura të shpëtimit copëtoheshin prej përplasjes në ujë. Ata që nuk dinin të notonin tërhiqnin ata që dinin të notonin drejt thellësisë së detit, shpërthyen përleshje për jelekët e shpëtimit, madje një oficer i dha fund jetës së tij me një pistoletë. Paniku ishte i pakontrollueshëm.

Një dramë tjetër po ndodhte nën kuvertë. Shumë robër lufte ndodheshin në një nga dhomat poshtë dhomave të ekuipazhit. Silura e kishte dëmtuar nga jashtë kaq keq derën e blinduar ku ndodheshin robërit, saqë me gjithë përpjekjet për t'i shpëtuar ishte e pamundur ta hapje derën qoftë edhe pak cm. Duhet të kenë ndodhur gjëra të paimagjinueshme në atë dhomë, sepse njerëzit e kuptuan shpejt se shpëtimi i tyre ishte i pashpresë. Sulmuesit e nëndetëses italiane nuk e kishin menduar se Linz-i do të kishte kaq shumë bashkatdhetarë.

**AKTI I FUNDIT**

Ora 01:15: Rreth 45 minuta pas goditjes me silurë anija ishte në pozicion vertikal dhe shpejt përfundoi në fund të detit. Linzi u mbyt e pastaj filloi beteja u fundit për të shpëtuar të mbeturit gjallë. Marinarët e torpedinieres 98M bënë të pamundurën njerëzore dhe shpëtuan më shumë se 130 vetë nga mbytja. Kryqëzori "Balaton" dhe torpediniera e dytë iu afruan Linz-it me shpejtësi të madhe deri në një farë distance dhe lundruan duke shpëtuar kështu më shumë se 200 vetë të tjerë.

Ora 02:00: Një heshtje e frikshme u kthye përsëri në det. Nuk shihej më asnjë në ujë që mund të shpëtohej.

**LINZI U HARRUA**

Sipas dokumenteve të gjitha përmasat e kësaj fatkeqësie nuk u bënë publike menjëherë. Vetëm tre muaj më vonë pas kësaj fatkeqësie iu bë kërkesë me shkrim parlamentit austro-hungarez për ta analizuar atë. Në parlament u kritikuan ashpër masat e sigurisë të lundrimit detar në detin Adriatik e, në mënyrë të veçantë, praktika e kthimit të ushtarëve nga leja në repartet e tyre në një numër të madh të pakontrolluar në bordin e anijeve të transportit detar. Megjithatë lufta po shkonte drejt mbarimit dhe monarkia drejt fundit të saj. U krijua një Republikë e re pa dalje në det dhe Linzi u harrua gradualisht. Duhej të kalonin shumë dhjetëvjeçarë deri në zbulimin e mbeturinave të Linzit nga zhytësit austriakë e të raportohej sërish për këtë tragjedi.

Për më tepër se 100 vjet prehet "Titaniku austriak" në ujërat detare shqiptare. Sa shumë persona gjetën varrin në fund të detit natën e mbytjes nuk do të sqarohet dot kurrë. Çdo viktimë e tragjedisë së mbytjes së "Linz"-it në 19 mars 1918, e cila ka banesën e fundit në detin Adriatik, ishte një viktimë më shumë. Le t´i kujtojmë përsëri këta njerëz, të ruajmë kujtimet dhe të vlerësojmë paqen në Europë.

*Alumnus i Universitetit të Vjenës 2012 dhe 2015-2017 punonjës i ambasadës austriake në Tiranë, Mik i Shqipërisë*

*Përkthyese: Suzana Hondro, Universiteti i Vjenës*

## HOROSKOPI

**DASHI**

Një njeri që e vlerësoni do t'ju bëjë një kritikë. Do t'jua bëjë atë me mirëbesim dhe me shumë politesë, por gjithsesi do t'ju hidhërojë së tepërmi! Tregohuni të arsyeshëm. Lëreni pas të shkuarën, dhe jetoni përvoja të reja me entuziazëm të plot, për të ardhmen.

**DEMI**

Jeni duke ndjekur objektiva që ju lodhin dhe ju stresojnë. Mos vallë për hir të kësaj keni lënë mënjanë dashurinë? Dëshira dhe pasioni do të bëjnë që të kërkoni mundësi për të biseduar dhe bashkëpunuar me partnerin më shumë se më parë.

**BINJAKET**

Me mbështetjen e shkëlqyer të Jupiterit do të zbuloni se keni talente të pashprehura, potencial praktik që duhet ta shprehni dhe ta shfrytëzoni. Urani mik do t'ju hapë rrugë të ndryshme. Do të keni një rol rëndësishëm, si në punë ashtu edhe në jetën shoqërore.

**GAFORJA**

Është ditë e përsosur për arritje profesioniale. Nëse ka pastaj një dashuri të re që po gatitet, mos humbi kohë dhe bëjeni të ditur! Mos u shqetësoni më për çështje që kanë të bëjnë më paraqitjen. Përqendrohuni në substancë, tek ekuilibri midis të qenit dhe të pasurit.

**LUANI**

Shfrytëzojeni çastin e mirëqenies shpirtërore për të dëgjuar më shumë dhe për t'i kushtuar më shumë kohë familjes. Ndërkaq, me Plutonin që ju del kundra, priten disa përgjegjësi që ndoshta mund t'ju kufizojnë disi lirinë. Por do t'ia dilni.

**VIRGJERESHA**

Ditën e sotme do të jeni më të ndjeshëm ndaj humorit të personave që ju rrethojnë. Zgjidhni me kujdes se me kë shoqëroheni. Do të keni mundësinë për të shprehur konkretisht altruizmin tuaj dhe të ndihmoni ata që do të kenë nevojë për ju.

**PESHORJA**

Gjëra të reja të vogla dhe gëzime të vogla ju presin dhe do të ishte më mirë të fillonit të mësonit të përfitoni nga këto. Ndërgjegjësimi për atë që është me të vërtetë e rëndësishme do t'ju ndihmonte të kalonit disa zënka me personin e dashur.

**AKREPI**

Në çift, disa kërkesa për pushtet nuk funksionojnë. Hapni rrugë. Nëse do të jeni më mirënjohës, rezultatet nuk do të vonojnë të vijnë. Mos u merrni me gjëra që hanë diskutim. Duke këmbëngulur do ta kuptoni se e keni pasur gabim.

**SHIGJETARI**

Gaboni me kokëfortësi për mbrojtur qetësinë tuaj, por partneri, duke e kuptuar, do t'jua falë. Me pak fjalë do të jeni edhe më të bashkuar se më parë. Mos jini koprrac kur vjen puna për të treguar dashurinë e juaj. Njerëzit që ju rrinë në krah e meritojnë plotësisht.

**BRICJAPI**

Nëse në jetën e në çift, xhelozia dhe dyshimet do t'i kalonin nivelet e normales, jepini fund kur të mundeni dhe ndërroni menjëherë drejtim. Planetët nuk janë shumë të favorshëm ndaj jush. Humori jo i mirë do të pengojë bashkëpunimin me një koleg.

**UJORI**

Saturni vazhdon t'ju mbrojë dhe të përkrahë ndërmarrjet tuaja. Fitoni menjëherë. Përpiquni të ndihmoni edhe dikë që ka nevojë. Do të vazhdojë periudha e qetësisë së madhe ekonomike dhe profesionale. Përfitoni sa më mirë.

**PESHQIT**

Do të shtyni në një datë të pacaktuar një takim që nuk doni ta bëni. Pse doni të humbni kohë me atë që e dini që në fillim se nuk është e përshtatshme për ju? Mërkuri Marsi dhe Venusi nuk shkojnë mirë, prandaj edhe ju duhet të kontrolloni nervozizmin e juaj.

Opinioni *i* Ditës

# Marsi, pranvera e lirisë

## *(Besë me atdheun dhe flamurin)*

Nga Azgan Haklaj

*(Vijon nga faqja e parë)*



… në botë. Në këtë ditë çdo gjë rigjallërohet, lind shpresë, ringjallje për gjithë njerëzimin. Novruz do të thotë ditë e re, është festa e Bektashizmit, e dekretuar si festë zyrtare në vitin 1996 në Shqipëri.

22 Marsi, ditëlindja e Imam Aliut, është dhe dita e fitores së PD-së, partisë misionare të kombit shqiptar, që shembi diktaturën më të egër, komunizmin në Shqipëri.

Marsi është për shqiptarët muaji i ngjarjeve dhe personazheve të mëdha, të cilat shndritin fort dhe përgjithmonë në qiellin shqiptar. Në krye të vendit qëndron natyrshëm 2 marsi i vitit 1444 i Besëlidhjes së Lezhës, vepra e parë e pavdekshme e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriotit - Skënderbeut.

Nëse shqiptarët historia i ka qortuar shpesh për vonesë e përgjumje, muaji i parë i pranverës i ka gjetur përherë në këmbë në kuvende e beteja të mëdha për mbrojtjen e lirisë dhe trojeve etnike.

Betejat e përgjakshme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Kryengritja e Malësisë së Madhe, e udhëhequr nga Dedë Gjon Luli, që filloi më 25 mars 1911.

"Epopeja e Jasharëve", më 5-6-7 mars 1998-të dhe e Haradinajve, më 24 mars 1998.

Rënia heroike e Njazi Azemit, më 26 mars 2001, për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Preshevë e që janë finalizimi i protestave.

Në Prishtinë, në marsin e vitit 1981 dhe 1999, jehuan krismat e para të pushkëve të lirisë në Kalanë e Tetovës gjatë protestave të shqiptarëve në Tetovë.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Rambujesë nga delegacionet shqiptare-angleze dhe amerikane, më 18 mars 1999-tës, që i hapte rrugë qëllimit të bombardimit të NATO-s mbi Serbinë, më datë 24 mars 1999, na kujtojnë se pa marsin nuk do të kishte liri për Shqiptarët.

7 marsi 1887-ës, ditëlindja e Shkollës së Parë Shqipe, na sjell në kujtesën tonë historike devizën e madhe të rilindësve mendjendritur me pushkë e penë për mëmëdhenë.

Alfabeti dhe shkronjat shqipe janë po aq të rëndësishme sa pushka dhe baruti i trimave që i dolën për zot atdheut dhe u flijuan për lirinë.

Ky muaj i heroizmit, i patriotizmit dhe i vizionit të shqiptarëve për liri, na sjell në kujtesën kolektive figurat e mëdha të popullit shqiptar në një shtrirje kohore 600-vje?are: Skënderbeun e madh, Ali Pashë Gucinë, Bajram Currin, Idriz Seferin, Dedë Gjon Lulin, Preng Calin, Adem Jasharin dhe familjen e tij martire, familjen Haradinaj e Njazi Azemin.

Marsi i 1444-ës mbeti flakadani i lirisë i pashuar në shekuj. Ashtu si në Greqinë e lashtë, trimat e Shqipërisë morën flakën Olimpike për ta shpërndarë në çdo cep të trojeve amtare e për të ngritur peshë zemrat e shqiptarëve përballë armiqve të egër dhe të armatosur deri në dhëmbë.

Më 14 mars 1847 lindi dhe 25 mars 1927 ndërroi jetë udhëheqësi i kryengritjeve të Shqiptarëve, Idriz Seferi, i cilësuar si kalorësi i Karadakut nga shkrimtari Ibrahim Kadriu. Historiani Ali Riza Selmani thotë se: Idriz Seferi ishte organizator i zoti që frymëzoi, motivoi dhe udhëhoqi shumë kryengritje në Anomarovë, Kosovën Juglindore dhe trojet e tjera shqiptare. Nuk ishte vetëm prijës popullor dhe luftëtar i lirë, por dhe strateg ushtarak, që udhëhoqi popullin e tij në luftëra e beteja për çlirim.

Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë me kufij të cunguar, ndonëse ishte në moshë të shtyrë, luftoi kundër serbëve e bullgarëve.

Idriz Seferi luajti një rol të rëndësishëm në organizimin dhe mbrojtjen në Kuvendin e Ferizajt gjatë korrikut të vitit 1908, i cili rezultoi me ngadhënjimin e Revolucionit Xhonturk. Në Luftën e Parë Ballkanike, së bashku me vullnetarët e tij, luftoi heroikisht në mbrojtje të Atdheut.

Më datë 29 mars të 1925 ra Heroi i Popullit, Bajram Curri. Prijësi popullor tribuni i lirisë, mori pjesë në betejat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për mbrojtjen e trojeve etnike nga konferencat dhe traktatet që kërkonin copëtimin e tyre. Bajram Curri ishte një nga organizatorët e Lidhjes së Pejës "Besa-Besë", të udhëhequr nga Haxhi Zekë Byberi më 1899-1900-të. Ai ishte një nga prijësit kryesorë të Kuvendit të Ferizajt. Mbështeti kryengritjen e armatosur të Malësisë së Madhe në vitin 1911-të të udhëhequr nga Dedë Gjo Luli. Mbështeti Platformën e Hasan Prishtinës në Kuvendin e Junikut, më 21-25 maj 1912, ku u hartua Platforma e Kryengritjes të Përgjithshme të vitit 1912, që do të çonte në çlirimin e Shkupit, në gusht 1912-tës dhe në Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe ngritjen e Flamurit në Vlorë më 1912-ën nga plaku i urtë, Ismail Qemali.

Më 5 mars 1888 ndërroi jetë Ali Pashë Gucia nga plagët e marra në një atentat , një ndër misionarët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe një nga figurat e dalluara të Këshillit Kombëtar të saj. Ali Pashë Gucia ishte një nga udhëheqësit kryesorë të rrymës centriste, që hartoi luftën kundër shovinistëve fqinjë për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Atdheut. Ai u zgjodh kryetar i Shtabit Ushtarak për Mbrojtjen e Plavë-Gucisë. Veprimtarinë e tij heroike e ka përshkruar bukur Gjergj Fishta.

Betejat legjendare për mbrojtjen e Plavë-Gucisë, të Hotit dhe Grudës, të Ulqinit dhe Tivarit nga ushtritë Malazeze.

Kryengritja e Malësisë së Madhe e 1911-ës.

Epopeja e Jasharëve dhe e Haradinajve, iu treguan fuqive të mbarë botës se Shqiptarët janë në gjendje të përtërijnë rolin e madh të Gjergj Kastriotit sa herë e thërret liria për të mbrojtur flamurin kuq e zi, nderin, dinjitetin dhe tokën e tyre amtare.

Prijësit e shquar të betejave për liri: Idriz Seferi, Bajram Curri, ndërruan jetë në mars.

Më 25 mars të 1945 komunistët pushkatuan heroin e mbrojtjes së tokave etnike shqiptare, "Robin Hudin shqiptar", Prenk Calin.

Epopeja e këtyre trimave është e denjë për një Iliadë shqiptare.

Ali Pashë Gucia e Jakup Ferri t'i kujtojnë Kreshnikët e Jutbinës.

Beteja 3 ditore e Adem-Hamz-Shaban Jasharit, Vraninën e Oso Kukën dhe heroizmin e Zhuj Selmanit.

Në epikën historike shqiptare kanë mbetur të pavdekshme vargjet kushtuar Epopesë marsiane shqiptare dhe heronjve të tyre.

Ja si përshkruhet beteja legjendare për mbrojtjen e Plavë-Gucisë, ku shqiptarët të udhëhequr nga Ali Pashë Gucia e Jakup Ferri i shpartalluan hordhitë malazeze të Mark Milanit të 12.000 armiqve:

Mark Milani i Malit të Zi  
Ka hyp Marku në Plevi  
Çka ka Limi që dirgjet zi  
Haj medet vojnikët e mi…!

Jakup Ferri, "Leonidha shqiptar", luftonte me shpatën zhveshur si Akili në muret e Trojës. Kënga e lahuta shqiptare i skalitën një monument të pavdekshëm:

Me të kallzue ty nanë t'vjen seri:  
30 burra i ka pré nji njeri.  
Nja lypsh emnin: Jakup Ferri.

Shtimja, Kaçaniku, Cerrnaleva, Hoti e Gruda, Ulqini, Plava e Gucia u bënë kala të pavdekshme të qëndresës shqiptare duke i detyruar pushtuesit turko-sllavë, e Fuqitë e Mëdha të mos bëjnë hesapet pa hanxhinë, siç thotë populli ynë.

Emisarët e Sulltanit e të Knjaz Nikollës pasi u shpartalluan keqas në fushëbeteja me shqiptarët tentuan disa herë të blejnë prijësit e tyre historikë duke i peshuar me ar, por morën atë përgjigje që dinë të japin kapedanët e maleve: "As Sulltani, as krajlat, nuk kanë para për t'i blerë trojet shqiptare".

Plisat e Bardhë dhe xhamadanët kuq e zi, trimat legjendarë nuk pranuan të shkëmbenin me kapicat, dallamat malazeze dhe me shallvaret e turqve.

Besëlidhja shqiptare bëri pluhur dhe hi planet e armiqut që përmes parullës të famshme "Përça dhe sundo" tentuan të fusnin grindje mes shqiptarëve duke shpresuar ndarjet krahinore dhe fetare.

Pasi u shpartalluan në Plavë-Guci, Mali i Zi i kërkoi Portës së Lartë dhe Kongresit të Berlinit t'i jepte si këmbim Hotin dhe Grudën me pretekstin se janë katolikë dhe ushtria e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nuk do të bënte rezistencë. Kur mijëra luftëtarë shqiptarë vrapuan në ndihmë të vëllezërve të tyre dhe i shpartalluan ushtritë malazeze, çështja shqiptare në Ballkan u ndërkombëtarizua dhe u vu në rend të ditës në kancelaritë e Fuqive të Mëdha. Shqiptarët ishin të udhëhequr nga postulati i rilindësit Pashko Vasa: "Feja e shqiptarit është Shqiptaria"

Ja si e konceptonte legjendari Mic Sokoli nderin dhe dinjitetin shqiptar, i rrethuar nga të katër anët nga trupat e pashait turk, ai thërret në ndihmë trimat e Dukagjinit. Kënga e thotë:

Mic Sokoli i Sokol Ramës,  
Fjalë po i çon Mark Lulës Shalës,  
A më ndihmon, o dajë i babes,  
Më kanë ngreh topat rrethit arës  
Rrethit arës, rrethit t'oborrit,  
Me shemb kullat Mic Sokolit…

Përballë ushtrive perandorake, të armatosur me topa, mitraloza mortaja, "Luani i Malësisë" dhe pse me forca të pakta, ishte betuar të luftonte deri në vdekje, siç bëri përpara tij Oso Kuka i Vraninës, Zhuj Selmani e pas tyre Adem Jashari në Prekazin legjendar.

Dashuria për Atdheun, gjuhën, flamurin, doket, zakonet, amanetin, kujtimin e të parëve, janë ADN-ja e burrave që besën e lidhën vetëm me Flamurin e Atdheun e tyre.

Ja si e arsyeton qëndresën e tij, deri në flijim heroi Mic Sokoli:

Me lëshue trojet poshtë po bie  
Me venë Çallmën spo m"ka hije  
Se jam nip i Kastriotit  
Më mirë gjoksin në grykë të topit.

Në vigjilje të mijëvjeçarit të tretë, më 5-6-7 mars të 1999-ës në Prekazin legjendar u shkrua Epopeja e lavdishme e Jasharajve. Komandanti legjendar i UÇK-së Adem Jashari e familja e tij i kthyen kullat e tyre në kala të pamposhtura qëndrese.

Në tri ditë u ripërsërit madhërishëm, krenaria, qëndresa shqiptare në shekuj. Ballë për ballë e dhëmbë për dhëmbë, si në Krujë, Shkodër e Sfetigrad e Albulenë kundër hordhive turke familja e Jasharajve e lau me gjakun e agresorëve oborrin e muret e kullave. Çdo frëngji e çardak u kthye në bedenë kalaje. Muret shembeshin nga predhat e topave e tankeve, e prapë nga gërmadhat dilnin Jasharajt e përgjakur duke qëlluar në drejtim të ushtrisë serbe. Luftuan deri në vdekje për të mbetur të pavdekshëm. Heroizmi i tyre ndryshoi fatet e luftës dhe u bë simbol i betejës për liri.

Më datë 24 mars 1998-ës bisha serbe do të sulmonte një tjetër fole shqiponjash në Glogjanin e Haradinajve. Këtu u shkrua me germa të arta një epokë tjetër e lavdishme e kombit shqiptar. Haradinajt trima me në krye Ramushin u dolën zot kullave legjendare, siç thotë kënga epike:

Tunden malet, por nuk tunden kullat.  
Në log të mejdanit po maten burrat.

Marsi i trimave, betejave e kuvendeve kujtohet me krenari. Shqipëria dhe shqiptarët janë një kudo ku ata jetojnë në trojet etnike, në Ballkan e diasporë.

Trinia e shenjtë: Gjuha, Flamuri e Atdheu, është burim frymëzimi i pashuar për ardhmërinë e përbashkët.

Ulqini i Teutës e Balshajve, ku prehen eshtrat e udhëheqësit të Lidhjes së Prizrenit, Ymer Prizreni, u bënë shumicë dominuese në qytetin e tyre.

Parlamenti i Maqedonisë e shpalli gjuhë zyrtare gjuhën shqipe, pra krismat e lirisë në 14 marsin e 2001 të U?K-së, po finalizojnë ëndrrën tonë. Marsi na thërret të jemi në këmbë e të bashkuar për të nderuar heronjtë tonë kombëtar dhe protagonistët e mëdhenj të historisë tonë, për të vazhduar misionin e tyre për realizimin e ëndrrës shumë shekullore pa harruar Mitrovicën e Bacës Isë, Preshevën e Ridvan Qazimit dhe ?amërinë tonë të shtrenjtë.

Viti i Gjergj Kastriotit, Skënderbeut është apel për finalizimin zgjidhjes së çështjes kombëtare, bashkimin e kombit shqiptar në një shtet të vetëm. Deviza jonë do të jetë: "Një komb, një shtet".

Shteti komb i shqiptarëve është domosdoshmëri historike.

## TRAJNERI I FLAMURTARIT




# Duro e ka sërish me gjyqtarët: Penalltia? Ishte si akullore

Flamurtari e ka humbur takimin e radhës në javën e 26-të, duke u mundur 1-0 në "Selman Stërmasi" nga ana e Partizanit. Në një intervistë për "Supersport", trajneri i Flamurtarit, Shpëtim Duro është shprehur se këtë ndeshje vlonjatëve u është mohuar një tjetër penallti, por në këtë rast duket si një rutinë. "Mungesat kanë qenë të shumta, por këto ndeshje janë shoqëruar me mosmarrjen e pikëve. Ky muaj ka qenë i tmerrshëm, por tashmë do të kemi muajin final. Kam qenë i pafat, pasi Muharemi dhe Tunkara nuk janë aktivizuar dhe pritet të aktivizohen në pjesën e mbetur të kampionatit. Nuk mund të quaj gabim ardhjen e tyre, por thjesht kanë qenë të pafat, pasi janë dëmtuar dhe nuk kanë pasur mundësi të tregojnë vlerat e tyre. Dua të përsëris faktin se në këtë muaj na janë bashkuar të gjitha gjërat e këqija, për të mbërritur në këtë moment. Nuk mund ta mohoj një ngërç psikologjik, por nuk mund të mohoj faktin se këta futbollistë janë shumë profesionistë. Sa i përket rastit të Hoxhajt, e kam thënë që më parë se ishte një penallti, pavarësisht se arbitri lejoi vazhdimin e lojës. Megjithatë, dua të them se unë jam i dorëzuar për diskutimin mbi arbitrat dhe kjo nuk është fatkeqësia më e madhe që na është bërë, madje kjo duket si një akullore për mua", është shprehur Shpëtim Duro.

Skuadra e Duros u paraqit me mungesa të shumta në kryeqytet dhe nuk u bëri dot ballë të kuqve

# Partizani gjen Edgar Çanin, sulmuesi ndëshkon Flamurtarin

## *8 muaj pritje për një gol trepikësh*


Jeton Selimi

8 muaj për të pritur këtë gol. 8 muaj vuajtje dhe durim nga ana e Edgar Çanit, që kërcen dhe me kokë thyen portierin Sali, duke shënuar një gol trepikësh për të tijtë. Një gol tipik prej qendërsulmuesi, një qendërsulmues që Partizani dhe gjithë ambienti i kuq e ka pritur gjatë, por në fund duket se e ka gjetur. Ndaj Flamurtarit, që në "Selman Stërmasi" paraqitej me mungesa, janë të kuqtë që kanë fjalën e parë duke kërcënuar që në shkëmbimet e para të topit. Më pas me kalimin e minutave loja balancohet disi, por pjesa e parë nuk do të dhurojë gola. Me fillimin e fraksionit të dytë Dalipi hedh në fushë Çanin, që e shpërblen me gol në minutën e 54-ët, kur kërcen mbi mbrojtësin dhe me kokë dërgon një parabël, që thyen Salin për epërsinë e të zotëve të shtëpisë. Sulmuesi shtatlartë realizoi edhe njëherë në minutën e 62-të, por goli u anulua për një pozicion jashtë loje, por siç shihet nga pamjet filmike, Çani është nisur në pozicion të rregullt. Gjithsesi, të kuqtë nuk lëshojnë metra dhe vijojnë të sulmojnë deri në fund, por sfida nuk dhuron më gola dhe Partizani merr një trepikësh të rëndësishëm që e ngjit në kuotën e 39 pikëve, dy më shumë sesa Luftëtari i vendit të pestë dhe 3 më pak sesa Laçi i vendit të tretë.




**ÇANI**

Partizani ka fituar ndaj Flamurtarit me rezultatin 1-0, duke u hakmarrë kështu për rezultatet e fundit të arritura në përballjet mes këtyre ekipeve. Futbollisti që vendosi fatin e këtij takimi ishte Edgar Çani. Në një intervistë për "Supersport", sulmuesi i Partizanit është shprehur me batutë se ka kërcyer më tepër kur ka festuar golin, sesa kur e ka shënuar atë. "Jam shumë i kënaqur, pasi në gjithë këto muaj që kam ndenjur jashtë fushës së blertë, kam pasur shumë pritje dhe punë, prandaj goli ishte një lehtësim për mua. Ne po punojmë për të marrë një formë sa më të mirë dhe çdo gjë tjetër do ia lëmë kohës. Konkurrenca në ekip është prezente edhe në rolin e tim, pasi çdo futbollist ka dhënë maksimumin. E dija që isha pjesë kryesore në këtë projekt, prandaj kam punuar shumë gjatë kohës kur kam qenë i dëmtuar dhe nuk mund të luaja për Partizanin. Nuk dua të komentoj asnjë vendim të arbitrit, pasi të gjithë gabojmë dhe kjo është e kuptueshme. Sa i përket momentit kur kam shënuar golin, mund të them se kam kërcyer më tepër gjatë festimit", është shprehur Edgar Çani.

**KATEGORIA SUPERIORE**

**JAVA E 26**

**TË DIELËN**

| | |
|---|---|
| Laçi - Kamza | 2-0 |
| Lushnja - Teuta | 2-3 |
| Skënderbeu - Luftëtari | 2-1 |

**TË HËNËN**

| | |
|---|---|
| Kukësi - Vllaznia | 2-0 |
| Partizani - Flamurtari | 1-0 |

**RENDITJA**

| Skuadra | P |
|---|---|
| Skënderbeu | 60 |
| Kukësi | 45 |
| Laçi | 42 |
| Partizani | 39 |
| Luftëtari | 37 |
| Flamurtari | 37 |
| Kamza | 34 |
| Vllaznia | 27 |
| Teuta | 26 |
| Lushnja | 10 |

## Trajneri i Kombëtares

# Panuçi, pa frerë në gjuhë: Në Kombëtare dua lojtarë me bo.e!

Kombëtarja i rikthehet futbollit të luajtur, ndërsa trajneri Kristian Panuçi suprizoi jo pak opinionin sportiv me listën e lojtarëve të grumbulluar për miqësoren kundër Norvegjisë. Tekniku italian lë jashtë kapitenin Ansi Agolli dhe komenti i tij i parë në konferencën për shtyp shkon pikërisht për të: "Në shtator Agolli mbush 36 vjeç, në momentet që fillojnë dhe eliminatoret zyrtare. Ne do të mendojmë për një zëvendësues, kam folur me Agollin dhe ia kam përcjellë këtë fakt, por në qoftë se do të kem nevojë, do ta kem në konsideratë. Është një profesionist shumë serioz. Do kisha dashur ta trajnoja kur ishte 28 vjeç". Jashtë Kombëtares mbetet Agolli, por emrat e rinj nuk mungojnë në listën e Panuçit. Për herë të parë fanellën kuqezi do ta veshin, Kristal Abazaj dhe Enis Gavazaj dy prurje nga Superliga, gjithashtu risi janë edhe Bujar Lika dhe Prenga. "E ndjek kampionatin shqiptar, pasi jam trajner i Kombëtares. Abazaj dhe Gavazaj më pëlqejnë, sepse janë lojtarët e duhur për mënyrën tonë të të luajturit. Ata janë lojtarë shumë të mirë një kundër një. Po luajnë shumë mirë, prandaj e meritonin një çmim. Duhet parë si do të luajnë me Kombëtaren. Kush bën mirë në kampionat, e grumbulloj. Nuk kam asnjë kompleks në këtë drejtim". Jo të gjithë zgjedhin si preferencë të parë Shqipërinë, rasti i Zhegrovës i ka shërbyer Panuçit për të lëshuar një sinjal të fortë. "Në fillim tha po, pastaj refuzoi. Ata nuk kanë bythë të bëjnë zgjedhje. Pyesin familjarët, më pas vendosin. Kam djem dhe lojtarë të shkëlqyer dhe nëse mua më thonë 'jo', ata nuk vijnë më në Kombëtare. Nuk më duhen lojtarë, të cilët nuk kanë bo.e të luajnë".



## Sukaj pretendoi një penallti

# Kukësi thyen Vllazninë, por ka polemika



Vllaznia nuk ia del të marrë pikë në "Zeqir Ymeri", humbet 2-0 me Kukësin në një sfidë ku nuk munguan rastet e dyshimta, ku më flagranti ishte momenti kur Alla ndërhyn ndaj Sukajt brenda zonës. Shameti dhe Musolli, dy futbollistë me karakteristika të theksuara mbrojtëse, bënë "sulmuesin" në këtë takim, duke siguruar tri pikë të vyera për kampionët në fuqi. Pas një starti disi të ekuilibruar, ku vëmendja e të dyja skuadrave ishte për të mos lënë hapësira prapa vjen goli i parë për Kukësin, me autor Ylli Shametin. Donjet Shkodra kroson saktësisht në shtyllën e dytë, aty ku mbrojtësi gjirokastrit, krejt i lirë, nuk i jep asnjë mundësi për të evituar golin portierit Sherri. Vllaznia detyrohet të shohë më shumë nga sulmi, madje në fund të pjesës së parë i afrohet barazimit me Sukajn, që përballë Frashërit nuk arrin ta dërgojë topin në rrjetë. Rast tepër i dyshimtë në zonën e Kukësit në minutën e 63-të. Alla ndërhyn ndaj Sukajt në mënyrë të parregullt, por për Hamitin nuk kemi të bëjmë me 11-metërsh. Një episod që lë shumë vend për diskutim. Pas rastit të humbur nga Ribaj në të 67'-ën, vjen goli i dytë i Kukësit, që shënohet pas një kundërsulmi të shpejtë nga kapiteni Musolli. Xhevahir Sukaj në të 88-ën i rrëmben nga duart topin portierit Frashëri, por për gjyqtarin Hamiti është një veprim i ndëshkueshëm me karton të verdhë. Për Sukajn ishte i verdhi i dytë, duke e lënë Vllazninë me një lojtar më pak. U mbyll 2-0 ky takim, që e kthen Vllazninë në një pozitë të vështirë, me vetëm një pikë më shumë se Teuta.

## Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Ferguson trainer.
6. Grand Prix
8. Është stacion beduinësh.
11. Një artikull jo për vegjetarian
12. Kujt i vjen... di të bëjë.
14. Kaçaturian kompozitor
16. Logot pa kufij
17. Parashtesë për vetë.
19. Aktorja protagoniste e Vertigo.
21. Ndezur në aparaturë.
23. Është si telefilm.
24. Ai i shtatë është kinemaja.
26. Është me shumë se kërkesë.
28. Cristiano bomber te Real Madrid.
29. Teket e grave.
31. Në krye të masave.
32. Shkon goja... nga nepsi.
33. Duken të gjata ato të pritjes.
35. Gjysmë bataku.
36. Është për medaljen e parë
37. Është kujdesi i babait.
39.... Maiden që këndojnë.
41. Një "bombë" tenistike.
42. Fillojnë mykjen
43. Janë këngëtarët si Jose Carreras
45. Është këngë e kënduar nga komiku
47. Lumë në Francë.
48. Piktori i Ura e Narnit.
49. Kapen në kufij

VERTIKAL
1. Në hyrje të ambientit
2. Neeson aktor.
3. Ente Sociale Rumune.
4. Ajo e zezë nënkpton arbitrin.
5. Kufizojnë stacionin.
6. Tremb fëmijët.
7. Jepet për t'u marrë.
8. Qytet japonez.
9. Është pemë
10. Janë tallësit.
13. Roberto trainer italian.
15. Freni këngëtare lirike.
18. Gjysmë totale.
20. Një si divan.
22. Tipare pa zë
23. Ulet në dhomën e lartë.
25. Moore aktor.
27. Qe bomber brazilian.
30. Ishte shpërthimi i Little Boy.
33. Carolina, e bukura e Belle epoque.
34. Mbarojnë fare
35. Pullman aktor.
37. Është thëllimi
38. Meg aktore.
40. Ndërmarrje Industriale Rajonale.
41. Një lidhëz.
44. Kaluar në krye.
46. Fundi i Turandot.

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Mund të hidhet te kiromanti
5. Teket e kafes.
8. D'Istria e Helena Gjikës
12. Smith filozof.
13. Kuke regjisor
14. Një pjesë e minoritetit.
15. Moduli i Neil Armstrong.
16. Mund të jenë qitjeje.
19. Markë pistolete.
20. Mbylli fushatat.
21. Është dorëzim.
22. Është detar.
23. Filloj ilustrimet.
24. Është hon.
25. Diftong në duel
27. Një pjesë e rifillimit.
28. Një që kuron karien.
31. Nganjëherë duhen vënë mbi i.
33. E egër dhe e fortë.
34. Janë thëniet e famshme.
35. Janë trupa qiellorë të tillë.
37. Inicialet e Stone regjisor
38. Memoria në computer
40. Në krye të trupave.
41. Mund të jenë diskografike.
44. Është e zakonshme për pushime
46. Skuadër greke.
47. Bel i Maupassant.
48. Është thesar.

VERTIKAL
1. E famshme ajo maqedonase.
2. Një zakon.
3. Bëjnë alarm me ar
4. Inicialet e Mallë regjisor
5. Mund të jetë telefonike
6. Ka dy faqe
7. Mund të jetë një cutter.
9. Në mes të dhomës.
10. Mbahet me bateri.
11. Përfshijnë edhe Haitin.
13. Denis i enëve me presion.
16. Paguhen për shërbime.
17. Janë ufo.
18. Ekstreme në tunel.
21. Një atentator vetëvrasës.
22. Markë cigaresh.
26. Arrihet duke mundur.
28. Jonathan, regjisor i Heshtja e qengjave.
29. Është aparati me zorrë.
30. Pak servilizëm.
31. Kështu e ka syrin vigjilenti.
32. Fatih trainer turk.
34. ... Nostra me mafiozët.
36. Mbyllin punimet.
39. Ai i shenjtë është papa.
42. Kufizojnë në teknik.
43. Fillojnë panikun.
44. Fund tuneli.
45. Në krye të armatës.



## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2 | | | 8 | | 3 | | |
| | | | 7 | | | | | 2 |
| | | 4 | | | | 9 | | 6 |
| | 9 | | | 2 | | | 4 | |
| | | | 1 | | 7 | | | |
| | 1 | | | 6 | | | 5 | |
| 9 | | 6 | | | | 8 | | |
| 7 | | | | | 1 | | | |
| | | 3 | | 4 | | | 2 | |

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 9 | 4 | 3 | 1 | 7 | 2 | 5 | 8 |
| 3 | 1 | 8 | 5 | 2 | 6 | 9 | 4 | 7 |
| 5 | 2 | 7 | 8 | 4 | 9 | 6 | 3 | 1 |
| 7 | 8 | 5 | 2 | 6 | 3 | 1 | 9 | 4 |
| 1 | 3 | 6 | 9 | 8 | 4 | 5 | 7 | 2 |
| 9 | 4 | 2 | 7 | 5 | 1 | 8 | 6 | 3 |
| 4 | 5 | 3 | 1 | 9 | 2 | 7 | 8 | 6 |
| 2 | 6 | 9 | 4 | 7 | 8 | 3 | 1 | 5 |
| 8 | 7 | 1 | 6 | 3 | 5 | 4 | 2 | 9 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)



FJALEKRYQI (2)



## Argëtim filozofik



- Nëntë të dhjetat e zgjuarsisë qëndron në të qënit i mençur në kohën e duhur. **(Teodor Ruzvelt)**
- I mencuri ka një prirje të fortë për të qenë i heshtur, dhe aftësinë për të ruajtur një inventar të tërë sekretesh. Zotësia dhe karakteri i tyre janë për t'u respektuar. **(Baltazar Gracian)**
- Zhurma nuk provon asgjë. Shpesh një pulë që ka bërë thjesht një vezë, kakarit sikur ka bërë një asteroid. **(Mark Tuein)**

## KRIPTOSKEME



## KRIPTOSKEME

*Përgjigja e numrit të djeshëm*



## Thënie të mençura

- Mos ec pas meje, unë s'udhëheq dot. Mos ec para meje, se mbase s'të ndjek. Ec pranë meje dhe të bëhemi miq. **( Albert Camus)**
- Dashuria ose është ose s'është! S'ekziston gjë e tillë si "dashuri e pakët" **Toni MORRISON (1931 -) Beloved**
- Suksesi është më i rrezikshëm se dështimi; dallgët thërrmohen në brigjet e qeta të detit. **Graham Greene**
- Mos u trego shumë i 'ndershëm' me të gjithë në këtë botë... Mos harro se pemët më të 'drejta' zgjidhen gjithmonë të parat për t'u 'prerë'..!

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

